



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.170

9 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1096, datë 4.11.2009	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të mbrojtjes personale”	7589
Vendim i KM nr.1097, datë 4.11.2009	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të boilerëve me ujë të nxhetë, që përdoren me gaz”	7603
Vendim i KM nr.1098, datë 4.11.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	7611
Vendim i KM nr.1163, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në Universitetin e Tiranës dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe studimi.	7612
Vendim i GJK nr.30, datë 26.11.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.91, datë 24.3.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën	7613

VENDIM
Nr.1096, datë 4.11.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE TË MBROJTJES PERSONALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të mbrojtjes personale”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet prej datës 1 dhjetor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE TË
MBROJTJES PERSONALE (PMP)

1. Fusha e zbatimit

1.1 Ky Rregull Teknik zbatohet për pajisjet e mbrojtjes personale, të referuara më poshtë si “PMP”.

Ky rregull përcakton kushtet e detyrueshme për vendosjen në treg të PMP, si dhe kërkesat thelbësore të sigurisë të cilat PMP duhet të përmbushin me qëllim që të sigurojë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e përdoruesve.

1.2 Për qëllime të këtij Rregulli Teknik, PMP është çdo mjet ose pajisje e paracaktuar për t’u veshur ose për t’u mbajtur nga një person për mbrojtje nga një ose më shumë rreziqe në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.

PMP gjithashtu mbulon:

- a) një njësi të përbërë nga disa mjete ose pajisje të cilat kombinohen në mënyrë të plotë nga fabrikuesi për mbrojtjen e një personi nga një ose më shumë risqe që mund të ndodhin në të njëjtën kohë;
- b) një mjet mbrojtës ose pajisje e kombinuar, e ndarë ose jo, me një pajisje personale jo mbrojtëse që vishet ose mbahet nga një person për zbatimin e një aktiviteti të veçantë;
- c) komponentët e këmbyeshem në një PMP të cilët janë kryesorë në funksionimin e sigurt të saj dhe përdoren vetëm për pajisje të tilla.

1.3 Çdo sistem i vendosur në treg i bashkuar me një PMP për ta lidhur këtë të fundit me një mjet tjetër plotësues të jashtëm, konsiderohet si një pjesë përbërëse e PMP edhe nëse sistemi nuk është parashikuar të vishet ose të mbahet nga përdoruesi gjatë gjithë kohës së veprimit të riskut.

1.4 Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për:

- a) PMP të mbuluara nga një tjetër rregull teknik i hartuar për të arritur të njëjtat objektiva si ky Rregull Teknik në lidhje me vendosjen në treg, lëvizjen e lirë të mallrave dhe sigurinë;
- b) klasat e PMP të specifikuar në listën e produkteve të përjashtuara në pikën 9, pavarësisht nga motivi i përjashtimit i dhënë në paragrafin e mësipërm.

2. Vendosja në treg dhe/ose në shërbim

2.1 PMP e mbuluar nga ky Rregull Teknik vendoset në treg dhe/ose në shërbim vetëm nëse ajo mbron shëndetin dhe garanton sigurinë e përdoruesve pa cenuar shëndetin ose sigurinë e personave të tjerë, kafshëve shtëpiake ose pronës, kur ajo mirëmbahet plotësisht dhe përdoret për qëllimin e saj të parashikuar.

2.2 Nuk pengohet paraqitja në panairë tregtare, ekspozita apo demonstrime të ngjashme me to e PMP që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli Teknik, me kushtin që një shënim qartësisht i dukshëm tërheq vëmendjen për këtë fakt. Ndalohet shitja dhe/ose përdorimi i kësaj PMP për çfarëdo qëllimi deri sa ajo të sillet në përputhje me gjithë kërkesat e këtij Rregulli Teknik nga personi që e vendos produktin në treg.

2.3 PMP e referuar në pikën 1.2 duhet të plotësojë kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në pikën 10.

2.4 Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg e PMP ose e komponentëve të PMP të cilat janë në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli Teknik dhe kanë të vendosur markimin CE që dëshmon konformitetin e tyre me të gjitha dispozitat e këtij Rregulli Teknik, duke përfshirë procedurat e vlerësimit të konformitetit për markimin CE, të dhëna në pikën 4.

2.5 Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg e komponentëve të PMP të cilat nuk kanë të vendosur markimin CE të cilat janë parashikuar të inkorporohen në PMP, me kushtin që ato nuk ndikojnë në funksionimin e sigurt të PMP.

2.6 PMP e referuar në pikën 4.3 dhe që mban markimin CE konsiderohet në përputhje me kërkesat thelbësore të referuara në pikën 2.3, në lidhje me të cilën fabrikuesi është në gjendje të paraqesë, nëse kërkohet, deklaratën e konformitetit të referuar në pikën 7.

2.7 PMP e referuar në pikën 4.2, konsiderohet se plotëson kërkesat thelbësore të referuara në pikën 2.3, nëse ajo mban markimin CE, në lidhje me të cilën fabrikuesi është në gjendje të paraqesë, sipas një kërrese, jo vetëm deklaratën e referuar në pikën 7, por gjithashtu dhe certifikatën e lëshuar nga organi i autorizuar/organizëm i regjistruar evropian (më poshtë i referuar si organ i autorizuar/organizëm evropian) që dëshmon përputhshmërinë e PMP me standardet e harmonizuara shqiptare, si dhe vlerësimin e saj në nivelin e shqyrtimit EC të tipit në përputhje me pikën 5.4.1 (a) dhe (b).

Kur fabrikuesi nuk ka zbatuar ose ka zbatuar pjesërisht standardet e harmonizuara shqiptare, ose kur nuk ka standarde të tilla, certifikata e lëshuara nga organi i autorizuar/organizmi evropian duhet të japë përputhshmërinë me kërkesat thelbësore në përputhje me pikët 5.4.1 b) dhe 5.4.2 c).

2.8 Numrat dhe titujt e standardeve të harmonizuara shqiptare me karakter referues, të referuara në pikën 2.7, botohen në Fletoren Zyrtare.

2.9. Nëse PMP është objekt dhe i rregullave të tjera teknike në lidhje me aspekte të tjera dhe të cilat gjithashtu parashikojnë markimin CE, kjo e fundit dëshmon se PMP prezumohet në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave Teknike.

2.10 Megjithatë, atje ku një ose më shumë nga këto Rregulla Teknike i lejojnë fabrikuesit, që gjatë një periudhe kalimtare, të zgjedhë cilin rregullim të zbatojë, markimi CE dëshmon përputhshmërinë me dispozitat e vetëm atyre Rregullave Teknike të zbatuara nga fabrikuesi.

Në këtë rast, veçantitë e Rregullave Teknike të zbatuara, të publikuara në Fletoren Zyrtare, duhet të jepen në dokumentet, shënimet ose instruksionet e kërkuara nga Rregullat Teknike që shoqërojnë PMP të tilla.

3. Lëvizja e lirë

3.1 Nëse gjendet se një PMP me markimin CE dhe që përdorur sipas qëllimit të parashikuar mund të rrezikojë sigurinë e personave, kafshëve shtëpiake ose pronën, Struktura Përgjegjëse për Mbikëqyrjen e Tregut merr të gjitha masat e nevojshme për heqjen e pajisjes nga tregu dhe ndalimin e tregtimit të tyre.

Struktura përgjegjëse e Mbikëqyrjes së Tregut menjëherë do ta informojë ministrinë për këtë veprim, duke treguar arsyet mbi vendimin e saj dhe veçanërisht nëse mospërputhja është e lidhur me:

- a) mungesën në plotësimin e kërkesave thelbësore të referuara në pikën 2.3,
- b) zbatimin jo të saktë të standardeve të referuara në pikën 2.7,
- c) mungesën në vetë standardet e referuara në pikën 2.7.

3.2 Nëse PMP nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse për markimin CE, Struktura Përgjegjëse e Mbikëqyrjes së Tregut do të ndërmarrë masat përkatëse përkundrejt personit përgjegjës që ka vendosur markimin dhe më pas do të informojë ministrinë.

4. Procedurat e vlerësimit të konformitetit për markimin CE

4.1 Përpara vendosjes në treg të një modeli PMP, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të plotësojë dokumentacionin teknik, siç referohet në pikën 11, dhe, nëse i kërkohet, e paraqet atë pranë Strukturës Përgjegjëse të Mbikëqyrjes së Tregut.

4.2 Përpara prodhimit të serive të PMP, me përjashtim atyre të referuara në pikën 4.3, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar paraqet një model për shqyrtimin EC të tipit, siç referohet në pikën 5, me anë të të cilit organi i autorizuar/organizmi europian tregon dhe vërteton se modeli PMP në fjalë plotëson dispozitat përkatëse të këtij Rregulli Teknik.

4.3. Shqyrtimi EC i tipit nuk kërkohet në rastin e modeleve të PMP të projekttimeve të thjeshta, për të cilat fabrikuesi pretendon se përdoruesi mund të vlerësojë vetë nivelin e mbrojtjes së siguruar përkundrejt risqeve minimale, efektet e të cilave, kur ato janë graduale, mund të identifikohen paraprakisht dhe pa problem nga përdoruesi.

Kjo kategori mbulon vetëm PMP e parashikuara për të mbrojtur përdoruesin nga:

- a) veprimi mekanik, efektet e të cilit janë sipërfaqësore (doreza për kopshtari, gishtëza etj.),
- b) materialet e pastrimit me veprim të dobët dhe me efekte lehtësisht të kthyeshme (doreza që lejojnë mbrojtjen nga solucionet të dobëta detergjentësh etj.),
- c) risqe të ndeshura nga prekja e komponentëve të nxehtë, të cilat nuk e vënë përdoruesin në një temperaturë më të madhe se 50°C, ose nga ndikime të rrezikshme (doreza, përparëse për përdorim profesional etj.),
- d) agjentët atmosferikë, që nuk janë as të jashtëzakonshëm, dhe as të natyrës ekstreme (kapele, veshje sezonale, këpucë etj.),
- e) përplasje të vogla dhe vibrime të cilat nuk ndikojnë në pjesët kryesore të trupit dhe efektet e të cilave nuk shkaktojnë dëmtime të pakthyeshme (kaska të lehta për mbrojtjen e lëkurës së flokëve, doreza, këpucë të lehta, etj.).

f) drita e diellit (syze dielli).

4.4 Prodhimi i PMP i nënshtrohet:

4.4.1 Sipas zgjedhjes së fabrikuesit, njëres nga dy procedurat e referuara në pikën 6 në rastin e PMP me projektim kompleks e parashikuar për të mbrojtur përdoruesin përkundrejt rrezikut nga vdekja ose nga rreziqe që seriozisht dhe në mënyrë të pakthyeshme dëmtojnë shëndetin, ndikimet e menjëhershme të së cilës projektuesi supozon se përdoruesi nuk mund t'i identifikojë në një kohë të mjaftueshme.

Kjo kategori mbulon vetëm:

- a) aparatet e filtrimit të ajrit për frymëmarrje për mbrojtje nga aerosolët e ngurtë dhe të lëngët, ose nga gazet irrituese, të rrezikshme, toksike ose radiotoksike,
- b) aparatet mbrojtëse të frymëmarrjes që sigurojnë një izolim të plotë nga atmosfera, duke përfshirë dhe ato që përdoren për zhytje në ujë,
- c) PMP që sigurojnë vetëm mbrojtje të kufizuar përkundrejt sulmeve kimike ose përkundrejt rrezatimeve jonike,
- d) pajisjet për përdorim në ambiente me temperaturë të lartë, efektet e së cilës janë të krahueshme me ato të një temperature të ajrit 100°C ose më shumë, dhe e cila mund të karakterizohet ose jo nga prania e rrezatimit infra të kuq, flakëve ose nga kalimi e sasive të mëdha të materialeve të shkrira,
- e) pajisjet për përdorim në ambiente me temperatura të ulëta, efektet e së cilës janë të krahueshme me ato të një temperature të ajrit me 50°C ose më pak,
- f) PMP që mbrojnë kundrejt rënies nga një lartësi,
- g) PMP ndaj risqeve elektrike dhe tensioneve të rrezikshme, ose të përdorura si izoluese të tensionit të lartë të punës.

4.4.2 Deklaratës EC të konformitetit për të gjitha PMP të referuara në pikën 7.

5. Shqyrtimi EC i tipit

5.1. Shqyrtimi EC i tipit është procedura nëpërmjet së cilës organi i autorizuar/organizmi europian provon dhe deklaron se modeli në fjalë i PMP përmbush dispozitat përkatëse të këtij Rregulli Teknik.

5.2. Aplikimi për shqyrtimin EC të tipit bëhet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në një organ të vetëm të autorizuar/organizëm europian për modelin në fjalë.

5.3. Aplikimi përmban:

- a) emrin dhe adresën e fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, si dhe vendin e prodhimit të PMP në fjalë,
- b) dokumentacionin teknik të fabrikuesit të referuar në pikën 11. Ai do të shoqërohet nga një numër i përshtatshëm mostrash të modelit që do të aprovohet.

5.4. Organi i autorizuar/organizmi European do të kryejë shqyrtimin EC të tipit, në përputhje me procedurat e përmendura më poshtë:

5.4.1 Shqyrtimi i dokumentacionit teknik të fabrikuesit.

a) Ai shqyrton dokumentacionin teknik të fabrikuesit për të verifikuar përshtatshmërinë e tij në lidhje me standardet e harmonizuara të referuara në pikën 2.7.

b) Atje ku fabrikuesi nuk ka zbatuar, ose ka zbatuar pjesërisht, standardet e harmonizuara ose atje ku mungojnë këto standarde, organi i autorizuar/organizmi European duhet të kontrollojë përshtatshmërinë e zgjidhjeve teknike të zbatuara nga fabrikuesi në lidhje me kërkesat thelbësore, përpara shqyrtimit të përshtatshmërisë së dokumentacionit teknik të fabrikuesit në lidhje me këto zgjidhje teknike.

5.4.2 Shqyrtimi i modelit

a) Gjatë shqyrtimit të modelit, organi i autorizuar/organizmi european do të verifikojë që ai është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik të fabrikuesit dhe mund të përdoret me siguri të plotë për qëllimin e tij të parashikuar.

b) Ai kryen shqyrtimet dhe provat e nevojshme për të verifikuar përputhjen e modelit me standardet e harmonizuara shqiptare.

c) Atje ku fabrikuesi nuk ka zbatuar, ose ka zbatuar pjesërisht, standardet e harmonizuara, ose ku mungojnë standarde të tilla, organi i autorizuar/organizmi european kryen shqyrtimet dhe provat e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e modelit me zgjidhjet teknike të zbatuara nga fabrikuesi dhe plotësojnë kërkesat thelbësore.

5.5 Nëse modeli plotëson kërkesat përkatëse, organi i autorizuar/organizmi european harton një certifikatë të shqyrtimit EC të tipit dhe njofton aplikantin. Kjo certifikatë përmban gjetjet e shqyrtimit, tregon çdo kusht të lidhur me lëshimin e saj dhe përfshin përshkrimet dhe vizatimet e nevojshme për identifikimin e modelit të aprovuar.

Ministria, organe të tjera të autorizuar mund të mbajnë një kopje të certifikatës, dhe në përgjigje të një kërke të arsyeshme, një kopje të dokumentacionit teknik, si dhe raportet e shqyrtimeve dhe provave të kryera.

Dokumentacioni teknik mbahet në dispozicion të autoriteteve kompetente për 10 vjet që nga vendosja e PMP në treg.

Çdo organ i autorizuar që refuzon lëshimin e certifikatës së shqyrtimit EC të tipit, informon edhe organet e tjera të autorizuar për këtë qëllim.

Një organ i autorizuar që tërheq një certifikatë të shqyrtimit EC të tipit, menjëherë njofton ministrin që e ka autorizuar për këtë fakt, duke treguar arsyet e një vendimi të tillë.

6. Kontrolli i PMP së prodhuar

6.1 Sistemi i kontrollit EC i cilësisë për produktin përfundimtar

6.1.1. Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që procesi i prodhimit, duke përfshirë inspektimin përfundimtar të PMP dhe provat, siguron njëtrajtshmërinë e prodhimit dhe përputhshmërinë e PMP me modelin e përshkruar në certifikatën EC të tipit, dhe me kërkesat përkatëse thelbësore të këtij Rregulli Teknik.

6.1.2. Një organ i autorizuar/organizëm European i zgjedhur nga fabrikuesi, kryen kontrollet e nevojshme. Këto kontrolle do të kryhen të rastësishme, normalisht në intervale së paku një herë në vit.

6.1.3. Një mostër e përshtatshme e PMP e marrë nga organi i autorizuar/organizëm european shqyrtohet dhe i kryhen provat përkatëse të përcaktuara në standardet e harmonizuara për të treguar përputhshmërinë e PMP me kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik.

6.1.4. Nëse organi i autorizuar/organizmi european nuk është ai që ka lëshuar certifikatën përkatëse të shqyrtimit EC të tipit, ai do të kontaktojë organin e autorizuar/organizmin european, në rastin kur ka probleme në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së mostrave.

6.1.5. Organi i autorizuar/organizmi european i jep fabrikuesit një raport të provave. Nëse raporti konkludon që prodhimi nuk është i njëtrajtshëm, ose që PMP e shqyrtuar nuk është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën EC të shqyrtimit të tipit, ose me kërkesat përkatëse thelbësore, organi do të ndërmarrë masat përkatëse sipas natyrës së gabimit/eve të konstatuar dhe njofton ministrin që ka autorizuar organin që ka lëshuar certifikatën e shqyrtimit EC të tipit.

6.1.6. Fabrikuesi duhet të jetë në gjendje të paraqesë, nëse kërkohet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, raportin e organit të autorizuar/organizmit European.

6.2 Sistemi për sigurimin e cilësisë EC të prodhimit nëpërmjet mjeteve të monitorimit

6.2.1 Sistemi

6.2.1.1 Në këtë procedurë fabrikuesi paraqet një aplikim për aprovimin e sistemit të tij të kontrollit të cilësisë në një organ të autorizuar/organizëm europian të zgjedhur nga ai vetë.

Aplikimi do të përfshijë:

a) të gjithë informacionin lidhur me kategorinë e PMP në fjalë, duke përfshirë, sipas rastit, dokumentacionin në lidhje me modelin e miratuar,

b) dokumentacionin për sistemin e kontrollit të cilësisë,

c) deklarin për plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i kontrollit të cilësisë dhe mirëmbajtjen e tij në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.

6.2.1.2 Nën sistemin e kontrollit të cilësisë, çdo tip i PMP shqyrtohet dhe i kryhen provat përkatëse të referuara në pikën 6.1.3 për të kontrolluar përputhshmërinë e tyre me kërkesat përkatëse thelbësore të këtij Rregulli Teknik.

Dokumentacioni i sistemit të kontrollit të cilësisë përfshin veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm për:

a) objektivat e cilësisë, skemën organizative, përgjegjësitë e zbatuesve dhe kompetencat e tyre në lidhje me cilësinë e produktit,

b) kontrollet dhe provat që duhet të kryhen pas prodhimit,

c) mjetet që përdoren për të kontrolluar funksionimin eficient të sistemit të kontrollit të cilësisë.

6.2.1.3 Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson sistemin e kontrollit të cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson dispozitat e referuara në pikën 6.2.1.2. Ai pranon se sistemet e kontrollit të cilësisë që zbatojnë standardet përkatëse, të harmonizuara plotësojnë këto dispozita.

Organi i autorizuar/organizmi europian që kryen auditët do të bëjë të gjitha vlerësimet e nevojshme objektive të komponentëve të sistemit të kontrollit të cilësisë dhe veçanërisht do të kontrollojë nëse sistemi siguron përputhshmërinë e PMP të prodhuar me modelin e aprovuar.

Vendimi i komunikohet fabrikuesit. Ai do të përfshijë konkluzionet e kontrollit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

6.2.1.4 Fabrikuesi informon organin e autorizuar/organizmin europian që ka miratuar sistemin e kontrollit të cilësisë për çdo plan për të ndryshuar sistemin e cilësisë.

Organi shqyrton ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i kontrollit të cilësisë plotëson kërkesat përkatëse. Ai i komunikon fabrikuesit vendimin e tij. Vendimi do të përfshijë konkluzionet e kontrollit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

6.3. Mbikëqyrja

6.3.1 Mbikëqyrja ka si qëllim të sigurojë se fabrikuesi përmbush në mënyrë korrekte detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i kontrollit të cilësisë.

6.3.2 Fabrikuesi autorizon organin, që për qëllime inspektimi, të hyjë në vendet e inspektimit, provave dhe magazinimit të PMP dhe i siguron atij të gjithë informacionin e kërkuar, veçanërisht:

a) dokumentacionin mbi sistemin e kontrollit të cilësisë,

b) dokumentacionin teknik,

c) manualat e kontrollit të cilësisë.

6.3.3 Organi do të kryejë periodikisht auditime që të sigurohet se fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e aprovuar të kontrollit të cilësisë dhe i jep fabrikuesit një kopje të raportit të auditit.

6.3.4 Përveç sa më sipër, organi mund të bëjë vizita të palajmëruara te fabrikuesi.

Gjatë këtyre vizitave organi i autorizuar/organizmi europian i jep fabrikuesit një raport të vizitës dhe, nëse duhet, një raport auditimi.

6.3.5 Fabrikuesi duhet të jetë në gjendje të paraqesë pranë Strukturës Përgjegjëse të Mbikëqyrjes së Tregut raportin e organit të autorizuar/organizmit europian, nëse i kërkohet.

7. Deklarata EC e konformitetit të prodhimit

Deklarata EC e konformitetit është procedura me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar:

a) harton një deklaratë, duke treguar se PMP e vendosura në treg janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik;

b) vendos markimin CE të parashikuar në pikën 8.1.

8. Markimi CE

8.1 Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet CE në formën e treguar në pikën 12 të këtij Rregulli Teknik. Në rastin e përfshirjes së një organi të autorizuar/organizëm europian në fazën e kontrollit të prodhimit, siç tregohet në këtë Rregull Teknik, shtohet numri i tij i identifikimit.

8.2 Markimi CE vendoset në çdo pjesë të PMP së prodhuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme gjatë gjithë jetëgjatësisë së parashikuar të PMP; megjithatë, nëse kjo nuk është e mundur për shkak të karakteristikave të produktit, markimi CE mund të vendoset tek paketimi.

8.3 Ndalohet vendosja e markimeve mbi PMP, të cilat mund të mashtrojnë palët e treta, si në kuptimin, ashtu dhe në formën e markimit CE.

Çdo markim tjetër mund të vendoset tek PMP ose në ambalazhin e saj duke siguruar që të mos reduktohet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE.

8.4 Pa qenë në kundërshtim me pikën 3:

8.4.1 Atje ku konstatohet se markimi CE është vendosur në mënyrë të parregullt, personi që ka vendosur produktin në treg është i detyruar të sjellë produktin në përputhje me kushtet që lidhen me markimin CE dhe t'i japë fund shkeljes nën kushtet e vëna nga Struktura Përgjegjëse e Mbikëqyrjes së Tregut.

8.4.2 Atje ku mospërputhja vazhdon, merren të gjitha masat për të kufizuar ose ndaluar vendosjen në treg të produktit në fjalë ose të sigurojë se ai është tërhequr nga tregu në përputhje me procedurat e formuluar në pikën 3.

9. Lista e klasave të PMP që nuk mbulohen nga ky Rregull Teknik

a) PMP të projektuara dhe të prodhuara për përdorim nga Forcat e Armatosura ose të ruajtjes së ligjit dhe rendit (helmeta, mburoja etj.),

b) PMP për vetëmbrojtje (aerosol gjenerues, armë personale mbrojtëse etj.),

c) PMP e projektuara dhe të fabrikuar për përdorim privat përkundrejt:

i) kushteve të pafavorshme atmosferike (kapele, veshje sezonale, këpucë dhe çizme, çadra etj.),

ii) lagështisë dhe ujit (doreza për larje pjatash etj.),

iii) nxehtësisë (doreza etj.).

d) PMP e parashikuara për mbrojtjen ose shpëtimin e personave në anije ose në aeroplanë, dhe që nuk mbahen gjatë gjithë kohës,

e) helmetat dhe kaskat e parashikuara për përdoruesit e motoçikletave dhe triçiklave.

10. Kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë

10.1 Kërkesa të përgjithshme që zbatohen për të gjitha PMP.

PMP duhet të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme përkundrejt të gjitha risqeve të ndeshura.

10.1.1 Parimet e projektimit

10.1.1.1 Ergonomia

PMP duhet të projektohen dhe të fabrikohen që në kushtet e parashikuara të përdorimit, përdoruesi mund të kryejë normalisht aktivitetin e lidhur me riskun, ndërsa realizohet mbrojtja e përshtatshme në nivelin më të lartë të mundshëm.

10.1.1.2 Nivelet dhe klasat e mbrojtjes

10.1.1.2.1 Niveli më i lartë i mundshëm i mbrojtjes

Niveli optimal i mbrojtjes është që në projektim të merret parasysh, përveç zorit të imponuar nga mbajtja (veshja) e PMP, ndalimi i përdorimit të saj efektiv gjatë periudhës së ekspozimit të riskut ose zhvillimit normal të aktivitetit.

10.1.1.2.2 Klasat e mbrojtjes të përshtatura për nivele të ndryshme të riskut

Nëse kushtet e ndryshme të parashikuara për përdorim janë të tilla që mund të dallohen disa nivele të të njëjtit risk, klasat përkatëse të mbrojtjes duhet të merren parasysh gjatë projektimit të PMP.

10.1.2 Parrezikshmëria e PMP

10.1.2.1 Mungesa e risqeve dhe e faktorëve të tjerë të papëlqyeshëm që e shoqërojnë.

PMP duhet të projektohen dhe fabrikohen që të parandalojnë si risqet, ashtu edhe faktorët e tjerë të dëmshëm sipas kushteve të parashikuara të përdorimit.

10.1.2.1.1 Përshtatja e materialeve përbërëse

Materialet dhe pjesët e PMP, duke përfshirë çdo shpërbërje të produkteve të tyre, nuk duhet të kenë ndikim të dëmshëm në higjienën dhe shëndetin e përdoruesit.

10.1.2.1.2 Kushti i përshtatjes së sipërfaqes për të gjitha pjesët te PMP në kontakt me përdoruesin

Çdo pjesë e PMP në kontakt, ose në kontakt potencial me përdoruesin, kur pajisje të tilla vishen, nuk duhet të kenë pjesë të ashpra, maja të mprehta, ngritje dhe të ngjashme me to, të cilat mund të shkaktojnë irritime të tepruara ose dëmtime.

10.1.2.1.3 Pengesat maksimale të pranuar për përdoruesin

Duhet të minimizohet çdo pengesë e shkaktuar prej PMP nga lëvizjet që duhen bërë, nga qëndrimet që duhen adoptuar dhe perceptimin ndijor; nga ana tjetër PMP nuk duhet të shkaktojë lëvizje që rrezikojnë përdoruesin ose persona të tjerë.

10.1.3 Komoditeti dhe efektshmëria

10.1.3.1 Përshtatja e PMP me morfologjinë e përdoruesit

PMP duhet të projektohen dhe fabrikohen që të lehtësojnë pozicionimin e rregullt të përdoruesit për gjatë gjithë periudhës së parashikuar të përdorimit, duke pasur parasysh faktorët e ambientit, lëvizjet dhe qëndrimet e trupit që bëhen. Për këtë qëllim, duhet të mundësohet optimizimi i përshtatjes së PMP sipas morfologjisë së përdoruesit nëpërmjet gjithë mënyrave të përshtatshme si rregullime dhe sisteme të përshtatshme kapës ose parashikimin e një ndryshimi të diapazonit të madhësisë.

10.1.3.2 Lehtësia dhe fortësia e konstruksionit

PMP duhet të jenë mundësisht sa më të lehta, pa cenuar fortësinë e konstruksionit dhe efektivitetin e tyre.

Përveç kërkesave të tjera specifike të cilat ato duhet të plotësojnë që të sigurohet mbrojtja e mjaftueshme përkundrejt risqeve në fjalë (shiko pikën 10.3), PMP duhet të jenë në gjendje të përballojnë ndikimet nga fenomenet shoqëruese të mjedisit sipas kushteve të parashikuara të përdorimit.

10.1.3.3 Pajtuueshmëria e klasave apo tipave të ndryshëm të PMP të projektuara për t'u përdorur njëkohshëm.

Nëse i njëjti fabrikues tregton disa modele të klasave apo tipave të ndryshëm të PMP, ato duhet të jenë të përshtatura në pajtuueshmëri, me qëllim që ato të sigurojnë mbrojtje të njëkohshme të pjesëve të afërta të trupit ndaj risqeve të kombinuara,

10.1.4 Informacioni i dhënë nga fabrikuesi

Informacioni i hartuar dhe i shpërndarë nga fabrikuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar për PMP e vendosura në treg duhet që, përveç emrit dhe adresës, të përmbajë të gjithë informacionin përkatës mbi:

a) instruksionet e magazinimit (ruajtjes), përdorimit, pastrimit, mirëmbajtjes, shërbimit dhe dizinfektimit.

Produktet e pastrimit, mirëmbajtjes ose dezinfektimit të rekomanduara nga fabrikuesi nuk duhet të kenë efekt të kundërt mbi PMP ose mbi përdoruesit kur ato zbatohen në përputhje me instruksionet përkatëse;

b) rezultatet e regjistruara gjatë provave teknike për të kontrolluar nivelet ose klasat e mbrojtjes të përcaktuara për PMP në fjalë;

c) aksesorët e përshtatshëm të PMP dhe karakteristikat e pjesëve të duhura të ndërrimit;

d) klasat e mbrojtjes të përshtatshme kundrejt niveleve të ndryshme të riskut dhe kufizimeve përkatëse të përdorimit;

e) afatin e përdorimit ose kohën e përdorimit të PMP ose të komponentëve të saj;

f) mënyrën e paketimit të përshtatshme për transport,

g) kuptimin e çdo markimi (shiko 10.2.12);

h) emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të organit të autorizuar të përfshirë në fazën e projektimit të PMP.

Këto shënime duhet të jenë të sakta dhe të kuptueshme duke i dhënë së paku në gjuhën shqipe.

10.2. Kërkesat plotësuese të përbashkëta për disa klasa apo tipa të PMP

10.2.1 PMP që përfshijnë sisteme rregullimi përshtatjeje

Nëse PMP përfshin sisteme rregullimi përshtatjeje, këto duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të mos jetë e mundur përshtatja e tyre në mënyrë të parregullt pa dijeninë e përdoruesit sipas kushteve të parashikuara të përdorimit.

10.2.2 PMP që mbulojnë pjesë të trupit për t'u mbrojtur

PMP që mbulojnë pjesët e trupit për t'u mbrojtur duhet, mundësisht sa më shumë, të sigurojnë ajrosje të mjaftueshme për të zvogëluar djersitjen që lind gjatë përdorimit. Nëse kjo nuk mundësohet, duhet të pajisen me mjete që thithin djersën.

10.2.3 PMP për fytyrën, sytë dhe organet e frymëmarrjes

Duhet të minimizohet çdo kufizim i fushës së shikimit dhe pamjes së përdoruesit nga PMP për fytyrën, sytë dhe organet e frymëmarrjes.

Shkalla e neutralitetit optik e sistemeve të shikimit të këtyre klasave të PMP duhet të jenë në pajtueshmëri me tipin e saktësive relative dhe/ose aktivitetëve të zgjatura të përdoruesit.

Nëse kërkohet, ato duhet të trajtohen ose parashikohen me lehtësitë për të parandaluar formimin e lagështisë.

Modelet e PMP të parashikuara për përdorues që kërkojnë korrigjim të shikimit, duhet të mundësojnë që me veshjen të mbahen syze ose lente korrigjuese.

10.2.4 PMP subjekt i afatit të përdorimit

Nëse dihet se është e kufizuar jetëgjatësia e efektshmërisë së projektuar për një PMP, duhet të vendoset data e prodhimit dhe, nëse është e mundur, data e skadimit në mënyrë të paheqshme mbi çdo PMP ose komponent zëvendësues të vendosur në treg në atë mënyrë që të pengojë çdo keqinterpretim; ky informacion gjithashtu duhet të vendoset në mënyrë të paheqshme mbi ambalazh.

Nëse një fabrikues nuk është në gjendje të japë një vlerësim për afatin e shërbimit të PMP, shënimet e tij duhet të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke treguar nivelin e cilësisë së modelit dhe kushtet reale të magazinimit, përdorimit, pastrimit, shërbimit dhe mirëmbajtjes, gjë që mundëson blerësit ose përdoruesit të vendosin një kohë të arsyeshme mbi jetëgjatësinë e asaj pajisje.

Kur jetëgjatësia e efekshmërisë së pajisjes vjen si rezultat i përdorimit periodik të një procesi pastrimi të rekomanduar nga fabrikuesi, ky i fundit duhet, nëse është e mundur, të vendosë mbi çdo PMP të vendosur në treg një shenjë treguese, jep numrin maksimal të operimeve të pastrimit që mund të kryhen përpara se pajisja të nevojitet të inspektohet ose të hiqet nga përdorimi; në mungesë ose në pamundësi të kësaj, fabrikuesi duhet të japë këtë informacion në shënimet e tij për mënyrën e përdorimit të pajisjes.

10.2.5 PMP që mund të kapen gjatë përdorimit

Atje ku kushtet e parashikuara të përdorimit përfshijnë, veçanërisht, riskun se PMP mund të kapet nga një objekt në lëvizje duke krijuar një rrezik për përdoruesin, PMP duhet të ketë një kufi rezistent të përshatshëm, përtej të cilit komponenti përbërës i PMP këputet dhe rreziku eliminohet.

10.2.6 PMP për përdorim në ambiente shpërthyes

PMP e parashikuara për përdorim në ambiente shpërthyes duhet të projektohen dhe fabrikohen që të mos jenë burim i një harku elektrik, elektrostatisht ose induktiv ose shkëndijë elektrike që mund të shkaktojë ndezjen e një përzierjeje shpërthyes.

10.2.7 PMP e parashikuara për përdorim emergjent ose veshje dhe/ose zhveshje të shpejtë.

Këto klasa të PMP duhet të projektohen dhe fabrikohen për të minimizuar si kohën e kërkuar për t'u veshur, ashtu dhe (ose) hequr/zhveshur.

Për çdo sistem të fiksimit për veshjen ose zhveshjen korrekte, parashikohet që përdoruesi manovron lehtësisht dhe me shpejtësi.

10.2.8 PMP për përdorim në situata shumë të rrezikshme

Në shënimet e informacionit të dhëna nga fabrikuesi dhe që shoqërojnë PMP për përdorim në situata shumë të rrezikshme, siç referohet në pikën 10.6.4.1, duhet të përfshihen, veçanërisht, të dhënat e parashikuara për përdorim të veçantë nga persona të aftë të trajnuar dhe të kualifikuar për t'i interpretuar ato dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga përdoruesi.

Fabrikuesi gjithashtu duhet të përshkruajë procedurën që duhet përshtatur me qëllim që të kontrollohet se PMP është përshtatur në mënyrë korrekte dhe është funksionale kur vishet nga përdoruesi.

Nëse PMP përfshin një alarm, i cili aktivizohet në mungesën e nivelit normal të parashikur të mbrojtjes, ky duhet të projektohet dhe përshtatet për t'u kuptuar nga përdoruesi në kushtet e përdorimit për të cilat PMP është tregtuar.

10.2.9 PMP që përfshijnë komponentë që mund të ndreqen ose të hiqen nga përdoruesi.

Çdo komponent të PMP që mund të ndreqen ose të hiqen nga përdoruesi për qëllime zëvendësimi duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që të lehtësojë ndreqjen, heqjen dhe vënien pa përdorur mjete të tjera.

10.2.10 PMP për lidhje me një tjetër pajisje plotësuese të jashtme

Nëse PMP përfshin një sistem që lejon lidhjen me një pajisje tjetër plotësuese, mekanizmi i lidhjes duhet të projektohet dhe fabrikohet që të montohet vetëm për pajisjen e duhur.

10.2.11 PMP që përfshin një sistem qarkullimi të një fluidi

Nëse PMP përfshin një sistem qarkullimi të një fluidi, ky sistem duhet të zgjidhet ose të projektohet dhe të përfshihet që të lejojë përtëritjen e mjaftueshme të fluidit në afërsi të gjithë pjesëve të trupit që duhen mbrojtur, pavarësisht veprimeve të përdoruesit, pozicionit të trupit apo lëvizjeve brenda kushteve të parashikuara të përdorimit.

10.2.12 PMP që kanë një ose më shumë shenja identifikuese ose njohëse që direkt apo indirekt lidhen me shëndetin dhe sigurinë.

Shenjat identifikuese apo vlerësuese, që direkt apo indirekt lidhen me shëndetin dhe sigurinë të vendosura mbi këto PMP, duhet të kenë formën e piktogramave ose ideogramave të harmonizuara dhe të jenë plotësisht të lexueshme gjatë gjithë jetëgjatësisë së përdorimit të parashikuar për PMP. Përveç kësaj, këto shënime duhet të jenë të kompletuara, të sakta dhe të kuptueshme që të parandalojnë çdo keqinterpretim, dhe veçanërisht ku këto shënime përfshijnë fjalë apo fjali duhet të jenë të paktën në gjuhën shqipe.

Nëse PMP (ose komponent i PMP) është shumë e vogël që të lejojë të vendoset markimi i nevojshëm, informacioni përkatës duhet të jetë mbi ambalazh dhe në shënimet e fabrikuesit që shoqërojnë pajisjen.

10.2.13 PMP në formën e veshjeve të afta për të sinjalizuar praninë vizuale të përdoruesit

PMP në formën e veshjeve të parashikuara për kushte të përcaktuara përdorimi në të cilat prezenca e përdoruesit duhet të jetë e dukshme dhe individualisht e sinjalizuar me një (ose më shumë) mjet ose pajisje të vendosur për të lëshuar rrezatimin e dukshëm direkt ose të reflektuar të intensitetit të përshtatshëm ndriçues dhe vetive fotometrike dhe kalorimetrike.

10.2.14 PMP për shumë risqe

Të gjitha PMP e projektuara për të mbrojtur përdoruesin nga rreziqe potenciale që ndodhin në të njëjtën kohë, duhet të projektohen dhe fabrikohen të plotësojnë, veçanërisht, kërkesat thelbësore të specifikuara për çdo nga këto risqe (shiko 10.3).

10.3. Kërkesa të tjera specifike për risqe të veçanta

10.3.1 Mbrojtja ndaj efektit mekanik

10.3.1.1 Efektet e shkaktuara nga rënia ose lëshimi i objekteve dhe përplasja e pjesëve të trupit me një pengesë.

PMP e përshtatur për këtë tip risku duhet të jetë absorbuese e mjaftueshme e goditjes për të parandaluar dëmtimin që rezulton, veçanërisht, nga shkatërrimi ose nga depërtimi i pjesëve të mbrojtura, të paktën deri në një nivel të efektit-energji përtej të cilit dimensionet apo masat e depërtuara të mjetit absorbues pengojnë përdorimin efektiv të PMP për periudhën e parashikuar që mbahet veshur.

10.3.1.2 Rrëzimet

10.3.1.2.1 Parandalimi i rrëzimeve për shkak të rrëshqitjes.

Tabanët për këpucë të projektuara për të parandaluar rrëshqitjen duhet të projektohen, fabrikohen ose të pajisen me elementë të tjera shtesë për të siguruar mbështetje të kënaqshme nëpërmjet mbërthimit dhe fërkimit, duke pasur parasysh natyrën ose gjendjen e sipërfaqes.

10.3.1.2.2 Parandalimi i rënies nga një lartësi

PMP e projektuara për të parandaluar rënien nga një lartësi ose efektet e tyre duhet të përfshijnë një pajisje parzmorë trupi dhe një sistem lidhës i cili mund të lidhet në një pikë të sigurt ankorimi. Ajo duhet të projektohet që nën kushtet e parashikuara të përdorimit, minimizohet lëshimi vertikal i përdoruesit për të penguar përplasjen me pengesa dhe megjithatë forcat frenuese nuk arrijnë vlerën kufi në të cilën dëmtimi fizik ose gërvishtja ose këputja e ndonjë komponenti të PMP mund të shkaktojë rënien e përdoruesit.

Ajo duhet gjithashtu të sigurojë që mbas frenimit përdoruesi të rrijë në një pozicion të përshtatshëm në të cilin ai mund të presë ndihmë nëse kërkohet.

Shënimet e fabrikuesit duhet të specifikojnë në veçanti informacionin përkatës të lidhur me:

a) karakteristikat e kërkuara për sigurinë e pikës së ankorimit dhe hapësirën e nevojshme minimale poshtë përdoruesit;

b) mënyrën e përshtatshme të vënies së parzmores së trupit dhe të lidhjes së sistemit lidhës në pikën e sigurt të ankorimit.

10.3.1.3 Vibrimi mekanik

PMP e projektuar për të parandaluar efektet nga vibrimet mekanike duhet të jenë në gjendje që të sigurojnë dobësimin e mjaftueshëm të komponentëve të dëmshëm të vibrimit për pjesët e trupit në risk.

Në asnjë rrethanë nuk duhet që vlera efektive e përshpejtimeve të transmetuara te përdoruesi nga këto vibrime të kalojë vlerat limite të rekomanduara duke marrë parasysh maksimumin e parashikuar ditor të qëndrimit në risk të pjesës së trupit.

10.3.2 Mbrojtja ndaj shtrëngimit (statik) të pjesës së trupit

PMP e projektuar për të mbrojtur pjesë të trupit ndaj tensionit të shtrëngimit duhet, mjaftueshmërisht, të jenë në gjendje të zbusin efektet e saj për të parandaluar dëmtimet serioze ose ankesat kronike.

10.3.3 Mbrojtja nga dëmtime fizike (zmerilime, shpime, prerje, gërryerje)

Materialet përbërëse të PMP dhe komponentët e tjerë të projektuar për të mbrojtur të gjithë apo pjesë të trupit nga dëmtime sipërfaqësore të shkaktuara nga makineri, të tilla si zmerilimi, shpimi, prerje, grosimi etj., duhet të zgjidhen ose projektohen dhe të përfshihen për të siguruar që këto klasa PMP të garantojnë një rezistencë të mjaftueshme ndaj zmerilimit, shpimit dhe prerjes (shiko gjithashtu pikën 10.3.1) nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

10.3.4 Pengimi i mbytjeve (jelekët dhe krahët e shpëtimit, kostume shpëtimi)

PMP e projektuar për të penguar mbytjen duhet të jetë në gjendje të kthejë në sipërfaqe, sa më shpejt që të jetë e mundur, pa rrezikuar shëndetin e tij, një përdorues i cili mund të jetë i rraskapitur ose i pavetëdijshëm mbas rënies në një ambient uhor, dhe ta mbajë atë mbi ujë në një pozicion që i lejon frymëmarrjen ndërsa është duke pritur ndihmë.

PMP mund të jetë tërësisht ose pjesërisht pluskuese ose mund të fryhen me gaz i cili mund të çlirohet në mënyrë manuale ose automatike ose me gojë.

Nën kushtet e parashikuara të përdorimit:

a) PMP, pa cenuar funksionimin e kënaqshëm të tij, duhet të jetë në gjendje të përballojë efektet e ndikimit të ambientit uhor dhe të faktorëve mjedisorë të qenësishëm në atë ambient,

b) PMP duhet të jetë në gjendje të fryhet shpejt dhe plotësisht.

Atje kur kërkohet për kushte të veçanta të parashikuara të përdorimit, disa tipa të PMP duhet gjithashtu të plotësojnë një ose më shumë nga kërkesat plotësuese të mëposhtme:

a) duhet të kenë të gjitha mjetet e fryrjes dhe/ose një mjet sinjalizimi drite ose zonor,

b) duhet të kenë një mjet për varjen dhe kapjen në trup që përdoruesi mund të transportohet nga ambienti uhor,

c) duhet të jenë në gjendje për përdorim të zgjatur gjatë periudhës së aktivitetit të ekspozimit të përdoruesit, mundësisht e veshur nga risku i rënies në ambientin uhor ose të kërkuar për zhytjen e tij në të.

10.3.4.1 Mjetet ndihmëse për notim

Veshja e cila do të sigurojë një shkallë efektive të notimit, në varësi të përdorimit të saj të parashikuar, e cila është e sigurt kur vishet dhe lejon një mbështetje të sigurt në ujë. Nën kushtet e parashikuara të përdorimit, kjo PMP nuk duhet të kufizojë lëvizjen e lirë të përdoruesit, por duhet t'i lejojë atij, veçanërisht, të notojë ose të ndërmarrë veprime gjatë largimit nga rreziku ose të shpëtimit nga persona të tjerë.

10.3.5 Mbrojtja ndaj efekteve të dëmshme të zhurmës

PMP e projektuar për të parandaluar efektet e dëmshme të zhurmës duhet të jetë në gjendje të dobësojë këtë të fundit në atë masë që nivelet e njëvlershme të zhurmës të perceptuara nga përdoruesi të mos kalojnë vlerat e kufizuara ditore të dhëna në Rregullat Teknike përkatëse mbi mbrojtjen e punëtorëve nga risku i lidhur me ekspozimin ndaj zhurmës në punë.

Të gjitha PMP duhet të kenë të vendosur etiketën që tregon nivelin e zbutjes së zhurmës dhe vlerën e indeksit të dhënë nga PMP; kur kjo nuk është e mundur, etiketa vendoset në paketim.

10.3.6 Mbrojtja nga nxehtësia dhe/ose zjarri

PMP e projektuar për të mbrojtur të gjitha ose pjesë të trupit nga efektet e nxehtësisë dhe/ose zjarrit duhet të zotërojë një kapacitet termik ndaj izolimit dhe fortësi të përshtatshme mekanike për kushtet e parashikuara të përdorimit.

10.3.6.1 Materialet përbërëse të PMP dhe komponentët e tjerë

Materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të përshtatshëm për mbrojtjen ndaj nxehtësisë rrezatuese dhe konvektive duhet të kenë një koeficient të përshtatshëm të transmetimit të fluksit të rastësishëm të nxehtësisë dhe të jenë mjaftueshëm zjarrruduese për të penguar çdo risk të një ndezjeje rastësore nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

Nëse pjesa e jashtme e këtyre materialeve dhe komponentëve duhet të jetë reflektuese, fuqia reflektuese e saj duhet të jetë e përshtatur ndaj intensitetit të fluksit të nxehtësisë të shkaktuar nga rrezatimi i rrezeve infra të kuqe.

Materialet dhe komponentët e tjerë të pajisjeve të parashikuara për një përdorim të shkurtër në një ambient me temperaturë të lartë dhe për PMP e cila mund të spërkatet nga produkte të nxehta, të tilla si sasi të mëdha të materialit të shkrirë, duhet gjithashtu të ketë një kapacitet termik të mjaftueshëm për të mbajtur pjesën më të madhe të nxehtësisë së akumuluar derisa përdoruesi të ketë lënë zonën e rrezikut dhe të ketë hequr PMP e tij.

Materialet e PMP dhe komponentët e tjerë të cilat mund të spërkatet nga një sasi e madhe e produkteve të nxehtë duhet gjithashtu të zotërojnë një absorbim të mjaftueshëm të efektit mekanik (shiko pikën 10.3.1).

Materialet e PMP dhe komponentët e tjerë të cilat aksidentalisht mund të hyjnë në kontakt me flakë dhe me ato të përdorura nga pajisjet për shuarjen e zjarrit duhet gjithashtu të zotërojnë një shkallë të rezistencës ndaj zjarrit që i korrespondon klasës së riskut të lidhur me kushtet e parashikuara të përdorimit.

Ato nuk duhet të shkrihen kur janë të ekspozuara ndaj flakëve dhe të mos ndihmojnë në përhapjen e flakës.

10.3.6.2 Komplet i PMP i gatshëm për përdorim

Nën kushtet e parashikuara të përdorimit:

a) sasia e nxehtësisë e transmetuar nga PMP te përdoruesi duhet të jetë mjaft e ulët për të parandaluar nxehtësinë e grumbulluar gjatë veshjes në pjesë të trupit në risk nga ndikimi, nën çdo rrethanë, i dhembjes ose dëmtimit të shëndetit.

b) PMP duhet, nëse kërkohet, të pengojë futjen e lëngut ose avullit dhe nuk duhet të shkaktojë dëgjie që rezultojnë nga kontakti ndërmjet cipës mbrojtëse dhe përdoruesit.

Nëse PMP përfshin pajisje ftohëse për absorbimin e nxehtësisë me mjete të avullimit të lëngut ose sublimimit të një trupi të ngurtë, projektimi i tyre duhet të jetë i tillë që çdo substancë shpërthyesë e çliruar të shkarkohet nga një mjet i jashtëm dhe jo në drejtim të përdoruesit.

Nëse PMP përfshin një pajisje respiratore, kjo e fundit duhet të plotësojë në mënyrë të përshtatshme funksionin mbrojtës të caktuar të tij nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

Shënimet e fabrikuesit që shoqërojnë çdo model të PMP, të parashikuar për një përdorim të shkurtër në një ambient me temperaturë të lartë, duhet që veçanërisht të japin të gjitha të dhënat përkatëse mbi përcaktimin e maksimumit të lejuar të ekspozimit të përdoruesit ndaj nxehtësisë së transmetuar nga pajisja e përdorur në përputhje me qëllimin e parashikuar.

10.3.7 Mbrojtja ndaj të ftohtit

PMP e projektuar për të mbrojtur të gjithë ose pjesë të trupit ndaj efektit ftohës duhet të ketë një kapacitet termik izolues dhe fortësi mekanike në përshtatje me kushtet e parashikuara të përdorimit për të cilin ajo tregtohet.

10.3.7.1 Materialet përbërëse të PMP dhe komponentët e tjerë të PMP

Materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të përshtatshëm për mbrojtjen nga të ftohtit duhet të kenë një koeficient aq të ulët transmetimi të fluksit rastësor termik si kërkohet në kushtet e parashikuara të përdorimit.

Materialet e përkulshme dhe komponentët e PMP të parashikuara për përdorim në një ambient me temperaturë të ulët duhet të ruajnë shkallën e kërkuar të elasticitetit për lëvizjet dhe qendrimet e nevojshme të trupit.

Materialet e PMP dhe komponentët e tjerë që mund të spërkatet nga sasi të mëdha të produkteve të ftohta duhet gjithashtu të zotërojnë veti të mjaftueshme absorbuese mekanike (shiko pikën 10.3.1).

10.3.7.2 Kompleti i PMP i gatshëm për përdorim

Sipas kushteve të parashikuara për përdorim:

a) fluksi i transmetuar nga PMP te përdoruesi duhet të jetë mjaft i ulët për të penguar gjatë veshjes të ftohtin e akumuluar në çdo pjesë të trupit që mbrohet, duke përfshirë majat e gishtave në rastin e duarve ose këmbëve, nga ndikimi, nën çdo rrethanë, i dhembjes ose dëmtimit të shëndetit,

b) PMP duhet sa më shumë që të jetë e mundur të pengojë futjen e lëngjeve të tilla, si ujin e shiut, dhe duhet të mos shkaktojë dëmtime që rezultojnë nga kontakti ndërmjet cipës mbrojtëse të të ftohtit dhe përdoruesit.

Nëse PMP përfshin një pajisje respiratore, kjo duhet të plotësojë mjaftueshmërisht funksionin mbrojtës të caktuar nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

Shënimet e fabrikuesit që shoqërojnë çdo model të PMP të parashikuar për përdorim të shkurtër në ambient me temperaturë të ulët duhet të japin të gjitha të dhënat përkatëse për maksimumin e lejuar të ekspozimit të përdoruesit në të ftohtin e transmetuar nga pajisja.

10.3.8 Mbrojtja nga goditjet elektrike

PMP e projektuar për të mbrojtur të gjithë ose pjesë të trupit nga efektet e rrymës elektrike duhet të jetë mjaft e izoluar përkundrejt tensioneve me të cilat përdoruesi ka mundësi të ekspozohet nën shumicën e kushteve të pafavorshme të parashikuara.

Në këtë kuptim, materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të këtyre klasave të PMP duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të përfshihen si për të siguruar që rrjedhja e rrymës nëpërmjet cipës mbrojtëse, nën kushtet e provës në tensione të ngjashme me ato që takohen në vend është e minimizuar dhe, në të gjitha rastet, poshtë një vlere maksimale konvencionalisht e lejuar, që lidhet me prapenësinë e tolerancës.

Së bashku me ambalazhin e tyre, tipat e PMP që janë parashikuar vetëm për përdorim gjatë punës ose në aktivitete në instalimet elektrike të cilat janë ose mund të jenë nën një tension elektrik, duhet të kenë të vendosura shenja tregues/markime që tregojnë, veçanërisht, klasën e tyre të mbrojtjes dhe (ose) voltazhin përkatës operues, numrin e tyre serial dhe datën e prodhimit; gjithashtu duhet të parashikohet një hapësirë jashtë cipës mbrojtëse për një përshkrim të mëtejshëm të datës së hyrjes në shërbim dhe për provat periodike ose inspektimet që do të kryhen.

Shënimet e fabrikuesit duhet të tregojnë, veçanërisht, përdorimin specifik për të cilat këto tipa PMP janë parashikuar dhe natyrën dhe frekuencën e provave dielektrike për të cilat ato janë objekt gjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit.

10.3.9 Mbrojtja nga rrezatimi

10.3.9.1 Rrezatimi jo jonizues

PMP e projektuar për të parandaluar dëmet e menjëhershme ose kronike të syve nga burime të rrezatimit jo jonizues duhet të jenë në gjendje të absorbojnë ose reflektojnë pjesën më të madhe të energjisë së përhapur në gjatësitë e valëve të dëmshme pa ndikuar së tepërmi transmetimin e pjesës së padëmshme të spektrit viziv, perceptimin e kontrasteve dhe aftësinë e dallimit të ngjyrave kur kërkohet në kushtet e parashikuara të përdorimit.

Në këtë kuptim, syzet mbrojtëse duhet të projektohen dhe fabrikohen që të kenë, për çdo valë të dëmshme, një faktor transmetimi të spektrit të tillë që densiteti i ndriçimit i energjisë rrezatuese që mund të arrijë në sytë e përdoruesit nëpërmjet filtrit, të jetë e minimizuar dhe të mos kalojë maksimumin e vlerës së lejuar.

Për më tepër, syzet nuk duhet të dëmtohen ose të humbin vetitë e tyre për shkak të efekteve të rrezatimit të lëshuar nën kushtet e parashikuara të përdorimit dhe të gjitha mostrat e vendosura në treg duhet të mbajnë numrin e faktorit mbrojtës që i korrespondon kurbës spektrale të shpërndarjes të faktorit të tyre të transmetimit.

Syzet e përshtatshme për burime rrezatimi të të njëjtit tip duhet të klasifikohen në rendin ngritës të faktorëve të tyre të mbrojtjes dhe shënimet e fabrikuesit duhet të tregojnë, veçanërisht, kurbat e transmetimit, të cilat mundësojnë përzgjedhjen e PMP më të përshtatshme, duke pasur parasysh faktorë të tillë të qenësishëm të kushteve efektive të përdorimit si distanca nga burimi dhe shpërndarja spektrale e energjisë së rrezatuar nga ajo distancë.

Numri përkatës i faktorit mbrojtës duhet të vendoset nga fabrikuesi mbi të gjitha mostrat e syzeve filtruese.

10.3.9.2 Rrezatimi jonizues

10.3.9.2.1 Mbrojtja nga infektimi i jashtëm radioaktiv

Materialet përbërëse të PMP dhe komponentët e tjerë të projektuar për të mbrojtur të gjithë ose një pjesë të trupit nga pluhuri, gazet, lëngjet radioaktive apo përzjerjeve të tyre, duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të përfshihen për të siguruar që kjo pajisje pengon në mënyrë efektive depërtimin e ndotësve nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

Në varësi të natyrës apo kushteve të këtyre ndotësve, ngushtimi i rrjedhjeve mund të sigurohet nga padepërtueshmëria e cipës mbrojtëse dhe, ose nga çdo mjet tjetër i përshtatshëm, siç janë sistemet e ventilimit dhe presionit të projektuara për të parandaluar rishpërndarjen e këtyre ndotësve.

Çdo masë dezinfektimi për të cilën PMP është objekt nuk duhet të cenojë mundësinë e ripërdorimit të saj gjatë jetëgjatësisë së parashikuar të përdorimit për këto klasa pajisjesh.

10.3.9.2.2 Mbrojtja e kufizuar përkundrejt rrezatimit të jashtëm

PMP e parashikuar që të sigurojë për përdoruesit një mbrojtje të plotë nga rrezatimi i jashtëm, ose në pamundësi të kësaj, dobësimin e mjaftueshëm, duhet të projektohet që të kthejnë goditjen vetëm nga elektrone të dobëta (p.sh. beta), ose fotone të dobëta (p.sh. X gama)

Materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të këtyre klasave të PMP duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të përfshihen për të siguruar për përdoruesit shkallën e mbrojtjes të kërkuar për kushtet e parashikuara të përdorimit, pa lejuar një rritje të kohës së ekspozimit si një rezultat i rezistencës së plotë të veprimeve të përdoruesit, qëndrimeve të trupit ose lëvizjeve (shiko pikën 10.1.3.2).

PMP duhet të kenë një shënim tregues që tregon tipin dhe trashësinë e materialit/eve përbërës të përshtatshëm për kushtet e parashikuara të përdorimit.

10.3.10 Mbrojtja nga substanca të rrezikshme, agjentë infektivë dhe grimcat e pluhurit

10.3.10.1 Mbrojtja respiratore

PMP e parashikuar për mbrojtjen e organeve/aparatit të frymëmarrjes duhet të mundësojë për përdoruesin një furnizim me ajër kur ky fundit është i ekspozuar në një ambient të ndotur dhe, ose në një ambient që ka përqendrim të pamjaftueshëm të oksigjenit.

Ajri i siguruar për përdoruesin nga PMP duhet të përfitohet nga mjete të përshtatshme, p.sh. mbas filtrimit të ajrit të ndotur nëpërmjet mjetit apo pajisjes mbrojtëse ose nga një furnizim me tub nga një burim i pa ndotur.

Materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të këtyre klasave të PMP duhet të zgjidhen ose të projektohen dhe të përfshihen në atë mënyrë që të sigurojnë për përdoruesin frymëmarrjen dhe higjienën në frymëmarrje gjatë kohës së vënies nën kushtet e parashikuara të përdorimit.

Vendet e padepërtueshme në pjesë të fytyrës dhe presioni mbi frymëmarrje dhe, në rastin e mjeteve të filtrimit, kapaciteti i pastrimit duhet të jetë i tillë që në rastin e një atmosfere të ndotur, depërtimi i ndotësve të jetë mjaft i ulët që të mos dëmtojë shëndetin apo higjienën e përdoruesit.

PMP duhet të kenë markën e identifikimit të fabrikuesit dhe detajime për karakteristikat specifike të atij tipi të pajisjes të cilat, së bashku me instruksionet e përdorimit, i krijojnë mundësinë përdoruesit të trajnuar dhe të kualifikuar të përdorë me korrektësi PMP.

Në rastin e mjeteve filtruese, shënimet e fabrikuesit duhet gjithashtu të tregojnë afatet e ruajtjes gjatë magazinimit të filtrave si të reja dhe të mbahen në ambalazhin e tyre origjinal.

10.3.10.2 Mbrojtja përkundrejt kontaktit me lëkurën dhe sytë

PMP e parashikuara për të parandaluar kontaktin sipërfaqësor të një pjese të veçantë ose të gjithë trupit me substancat e rrezikshme dhe agjentë infektues duhet të jenë në gjendje të parandalojnë depërtimin ose përhapjen e substancave të tilla nëpërmjet cipës mbrojtëse, në kushtet e parashikuara të përdorimit për të cilat PMP është vendosur në treg.

Si përfundim, materialet përbërëse dhe komponentët e tjerë të këtyre klasave të PMP duhet të zgjidhen, ose projektohen dhe të përfshihen për të siguruar, sa më shumë të jetë e mundur padepërtueshmëri të plotë, e cila do të lejojë, nëse kërkohet, zgjatjen e përdorimit ditor, ose në pamundësi të kësaj, të limitohet padepërtueshmëria e caktuar e nevojshme për kufizimin e periudhës së veshjes.

Kur për një arsye të natyrës së tyre dhe kushteve të parashikuara të përdorimit të tyre, disa substanca të rrezikshme apo agjentë infektivë zotërojnë fuqi depërtimi të larta, të cilat kufizojnë kohën e mbrojtjes së parashikuar nga PMP në fjalë, kjo e fundit duhet të jetë objekt i provave standarde në kuptimin e klasifikimit të tyre mbi bazën e efektshmërisë.

PMP e cila konsiderohet në përputhje me specifikimet e provës duhet të mbajë një shënim tregues që tregon, veçanërisht, emrat ose në mungese të saj, kodet e substancave të përdorura në prova dhe periudhën standarde që i korrespondon mbrojtjes. Shënimet e fabrikuesit gjithashtu duhet të përmbajnë, veçanërisht, një shpjegim të kodeve (nëse është e nevojshme), një përshkrim të detajuar të provave standarde dhe të gjithë informacionin e përshtatshëm për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar për veshjen nën kushtet e ndryshme të parashikuara për përdorim.

10.3.11 Mjetet e sigurisë për pajisjet e zhytjes

10.3.11.1 Pajisjet e frymëmarrjes

Pajisja e frymëmarrjes duhet të mundësojë furnizimin e përdoruesit me përzierjen e gazeve për frymëmarrje, nën kushtet e parashikuara të përdorimit duke marrë parasysh veçanërisht thellësinë maksimale të zhytjes.

10.3.11.2 Nëse kushtet e parashikuara të përdorimit e kërkojnë, pajisja duhet të përfshijë:

- a) një kostum, i cili mbron përdoruesin nga presioni që rezulton në thellësinë e zhytjes (shiko pikën 10.3.2) dhe, ose nga i ftohti (shiko pikën 10.3.7),
- b) një alarm të projektuar për të dhënë të përdoruesit paralajmërimin e shpejtë të një mungese që po afrohët në furnizimin e përzierjes së gazeve të frymëmarrjes (shiko pikën 10.2.8),
- c) një kostum për shpëtimin e jetës që i mundëson përdoruesit të dalë në sipërfaqe (shiko pikën 10.3.4.1).

11. Dokumentacion teknik i dhënë nga fabrikuesi


Dokumentacioni i referuar në pikën 6.1 duhet të përmbajë të gjitha të dhënat përkatëse mbi mjetet e përdorura nga fabrikuesi për të siguruar se një PMP plotëson kërkesat thelbësore të lidhura me të.

Në rastin e modeleve të PMP të referuara në pikën 4.2, dokumentacioni duhet të përfshijë veçanërisht:

- a) dosjen teknike të përbërë nga:
 - i) skica të plota dhe të detajuara të PMP të shoqëruara, kur kërkohen, nga llogaritje dhe rezultate të provave të prototipit brenda kufirit të nevojshëm për verifikimin e konformitetit me kërkesat thelbësore;
 - ii) një listë të kërkesave thelbësore mbi sigurinë dhe të standardeve të harmonizuara shqiptare ose specifikimeve të tjera teknike të referuara në pikën 2.7 dhe në pikat nga 2.1 deri 2.3, që janë marrë parasysh në projektimin e modelit;
 - iii) një përshkrim të mënyrave të kontrollit dhe provave të përdorura në fabrikën/uzinën e fabrikuesit për të kontrolluar përputhjen e prodhimit të PMP me standardet e harmonizuara shqiptare ose me specifikimet e tjera teknike dhe mirëmbajtjes së nivelit të cilësisë;
 - iv) një kopje të informacionit të referuar në pikën 10.1.4.

12. Markimi CE i konformitetit dhe përshkrimet

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” si paraqitet në formën e mëposhtme:



Për shmangien e dyshimeve, deklarohet që rrjeta e dhënë në sfond të figurës së mësipërme nuk është pjesë e markimit CE.

Nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, duhet të respektohen raportet e dhëna në vizatimin e shkallëzuar më lart.

Komponentët e ndryshëm të markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale dhe që nuk duhet të jetë më pak se 5 mm. Kjo përmasë minimale mund të zvogëlohet për PMP me madhësi të vogël.

13. Kriteret minimale për vlerësimin e organeve të autorizuara
Organet e autorizuara nga ministri duhet të plotësojnë kushtet minimale të mëposhtme:
- a) disponueshmërinë e personelit, si dhe mjetet e pajisjet e nevojshme;
 - b) kompetencën teknike dhe integritetin profesional të personelit;
 - c) pavarësinë e stafit dhe personelit teknik në lidhje me të gjitha rrethet, grupet ose personat që drejtpërdrejt ose tërthorazi janë përfshirë në fushën e pajisjeve në kryerjen e provave, përgatitjen e raporteve, lëshimin e certifikatave dhe përmbushjen e mbikëqyrjes të parashikuara në këtë rregull teknik, menaxhim dhe staf teknik;
 - d) ruajtjen e sekretit profesional nga stafi;
 - e) nënshkrimin e sigurimit të përgjegjësisë civile sipas ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.
- Plotësimi i kushteve të dhëna në dy paragrafët e parë duhet që periodikisht të verifikohet nga organet e përcaktuara me ligj.

VENDIM
Nr.1097, datë 4.11.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË BOILERËVE ME UJË TË NXEHTË, QË PËRDOREN
ME GAZ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të boilerëve me ujë të nxehtë, që përdoren me gaz”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT
TE BOILERËVE ME UJË TË NXEHTË QË PËRDOREN ME GAZ

1. Fusha e zbatimit

Ky rregull teknik përcakton kërkesat e efikasitetit të energjisë të zbatuara te boilerët e rinj për ujë të nxehtë dhe që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë me një fuqi nominale jo më pak se 4 kW dhe jo më shumë se 400 kW; këtu e më poshtë të quajtur “boiler”.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij rregulli teknik :

- a) “Boiler” është një kombinim i konstruksionit të boilerit me djegësin, i projektuar për të transmetuar tek uji nxehtësinë e çliruar nga djegia.
- b) “Pajisje” është:
 - i) konstruksioni i boilerit i projektuar për t’u pajisur me një djegës;
 - ii) djegësi i projektuar për t’u montuar në konstruksionin e një boileri.
- c) “Fuqia efektive nominale” (e shprehur në kW) është fuqia kalorifike maksimale e deklaruar dhe e garantuar nga fabrikuesi që çlirohet gjatë funksionimit të vazhdueshëm të pajisjes dhe që është në përputhje me rendimentin e dobishëm të dhënë nga fabrikuesi.
- d) “Rendimenti i dobishëm” (i shprehur në %) është raporti i fuqisë së nxehtësisë së transmetuar në ujin e boilerit me prodhimin e vlerës së nxehtësisë specifike në presion konstant të lëndës djegëse me konsumin, të shprehur si sasi e lëndës djegëse në njësinë e kohës.

e) "Ngarkesa e pjesshme" (e shprehur në %) është raporti i fuqisë efektive të boilerit që funksionon me ndërprerje ose në fuqi më të ulët se fuqia efektive nominale, me fuqinë efektive nominale.

f) "Temperatura mesatare e ujit në boiler" është mesatarja e temperaturave të ujit të matura në hyrje dhe në dalje të boilerit.

g) "Boiler standard" është boileri për të cilin temperatura mesatare e ujit mund të kufizohet nëpërmjet projektit.

h) "Back-boiler" është boileri i projektuar të furnizojë një sistem qendror për ngrohje dhe instalohet në brendësi të një vatre zjarri si pjesë e një boileri/me kombinim djegie të gazit.

i) "Boiler me temperaturë të ulët" është boileri që mund të punojë vazhdimisht duke u furnizuar me ujë në temperaturë 35-40°C, ku në disa rrethana mund të ndodhë kondensimi, duke përfshirë edhe boilerët me kondensim që përdorin lëndë djegëse të lëngët.

j) "Boiler me kondensim me gaz" është boileri i projektuar për të kondensuar vazhdimisht një pjesë të madhe të avujve të ujit, që përmbajnë gazet e djegshme.

k) "Boiler që instalohet në hapësira banimi" është boileri me një fuqi efektive nominale më pak se 37 kW, i projektuar që të japë nxehtësi në pjesë të hapësirës së banimit, në të cilën ai është instaluar nëpërmjet emetimit të nxehtësisë nga vendi i montimit në hapësirën e dhomës, duke dërguar ujë të nxehtë me qarkullim të lirë; boilerë të tillë do të mbajnë në karkasën e tyre shenjën e qartë që ato duhet të instalohen në hapësira banimi.

3. Përrjashtime

3.1. Përrjashtohen nga ky rregull teknik:

a) boilerët për ujë të nxehtë që janë në gjendje të djegin lëndë djegëse të ndryshme duke përfshirë dhe lëndët djegëse të ngurta;

b) pajisjet për përrgatitjen e menjëhershme të ujit të nxehtë;

c) boilerët e projektuar për të djegur lëndë djegëse, vetitë e të cilave ndryshojnë dukshëm nga vetitë e lëndëve djegëse të lëngshme dhe të gazta që tregtohen gjerësisht (gaz mbetjesh industriale, biogas etj.);

d) sobat dhe pajisjet e projektuara kryesisht për të ngrohur mjedisin në të cilin ato janë instaluar dhe që kanë si funksion ndihmës furnizimin me ujë të nxehtë për ngrohjen qendrore dhe për nevoja higjieno-sanitare;

e) pajisjet me fuqi nominale më pak se 6 kW që përdorin qarkullimin e lirë dhe janë projektuar vetëm për prodhimin e ujit të nxehtë që ruhet për nevoja higjieno-sanitare;

f) boilerët e prodhuar jashtë serie;

g) "Pajisjet ko-gjeneruese" të cilat prodhojnë në të njëjtën kohë energji elektrike dhe ujë të nxehtë.

3.2 Në rastin e boilerëve me funksionim të dyfishtë, si për ngrohjen e ndërtesave, ashtu dhe për të siguruar ujë të nxehtë për nevoja higjieno-sanitare, kërkesat e efijencës të referuara në pikën 5.1 i përkasin vetëm funksionit të ngrohjes.

4. Mbikëqyrja e tregut

4.1 Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg ose në shërbim e pajisjeve dhe boilerëve, të cilat plotësojnë kushtet e këtij rregulli teknik dhe që kanë shenjën CE, të parashikuar në pikën 8, duke dëshmuar përputhjen me të gjitha kushtet e këtij rregulli teknik, duke përfshirë procedurat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në pikën 9.

4.2 Nuk lejohet vendosja në treg/në përrdorim të boilerëve të cilët nuk përmbushin kërkesat e efijencës të dhëna në pikën 5.1, si dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me kushtet klimaterike lokale, energjinë dhe karakteristikat e ndërtesave. Struktura përrgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se boilerët nuk mund të vendosen në shërbim, nëse ato nuk plotësojnë kërkesat e efijencës.

4.3 Megjithatë, struktura përrgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, në të gjitha ato raste kur back-boilerët dhe/ose boilerët që mund të instalohen në hapësira banimi janë plotësisht të instaluar përpara miratimit të këtij rregulli teknik, do të vijojnë të autorizojnë hyrjen e tyre në shërbim, me kusht që rendimenti i tyre si për fuqinë nominale, ashtu dhe në 30% të ngarkesës nuk është më shumë se 4% poshtë kërkesave të përcaktuara për boilerët standard në pikën 5.1.

4.4 Efektet e dispozitave në paragrafët 4.2 dhe 4.3 do të monitorohen në mënyrë periodike nga ministria përkatëse.

4.5 Zbatimi i rregullave të tjerë

a) Kur boilerët janë objekt edhe i rregullave të tjerë teknike, që mbulojnë aspekte të tjera, të cilat gjithashtu parashikojnë vendosjen e markimit CE, kjo e fundit do të tregojë se këta boilerë janë gjithashtu të prezumuar në përputhje me kushtet e këtyre rregullave teknike.

b) Kur një ose më shumë nga këto rregulla teknike e lejojnë fabrikuesin që gjatë një periudhe kalimtare, të zgjedhë cilin rregull të zbatojë, vendosja e markimit CE do të tregojë përputhjen vetëm me dispozitat e rregullave teknike të zbatuara nga fabrikuesi.

Në këtë rast, veçoritë e rregullave teknike të zbatuara, të publikuara në Fletoren Zyrtare, duhet të jepen në dokumentet, shënimet ose instruksionet e kërkuara nga rregullat teknike dhe që shoqërojnë boilerët.

5. Konformiteti me kërkesat thelbësore të efijencës (rendiment i dobishëm)

5.1 Boilerët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të rendimentit të dobishëm:

a) në fuqinë nominale, duke operuar në fuqinë nominale P_n të shprehur në kW, në një temperaturë mesatare 70°C të ujit të boilerit, dhe

b) në ngarkesë të pjesshme, duke operuar në 30% të ngarkesës, në një temperaturë mesatare të ujit të boilerit, e cila ndryshon sipas tipit të boilerit.

Kërkesat thelbësore të efijencës (të rendimentit të dobishëm) që duhet të plotësohen janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela

Tipi i boilerit	Kufiri i fuqisë	Efijenca në fuqi nominale		Efijenca në ngarkesë të pjesshme	
		Temperatura mesatare e ujit në boiler (në °C)	Kërkesa e efijencës e shprehur në (%)	Temperatura mesatare e ujit në boiler (në °C)	Kërkesa e efijencës e shprehur në (%)
Boilerët standardë	4 deri 400	70	$\geq 84 + 2 \log P_n$	≥ 50	$\geq 80 + 3 \log P_n$
Boilerë me temperaturë të ulët (*)	4 deri 400	70	$\geq 87.5 + 1.5 \log P_n$	40	$\geq 87.5 + 1.5 \log P_n$
Boiler me kondesim me gaz	4 deri 400	70	$\geq 91 + 1 \log P_n$	30 (**)	$\geq 97 + 1 \log P_n$

(*) Duke përfshirë boilerët me kondesim që përdorin lëndë djegëse të lëngët.

(**) Temperatura e ujit me të cilin furnizohet boileri.

5.2 Standardet e Harmonizuara Shqiptare, lidhur me kërkesat e këtij rregulli teknik, do të përcaktojnë, ndër të tjera, edhe metodat e verifikimit të vlefshme për prodhimin dhe matjet.

Tolerancat e përshtatshme duhet të përfshihen në nivelet e rendimentit.

6. Vendosja e markimit CE të konformitetit

6.1 Boilerët të cilët janë në përputhje me Standardet e Harmonizuara Shqiptare, numrat e referimit të të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, plotësojnë kërkesat thelbësore të efijencës të përcaktuara në pikën 5.1. tek këta boilerë duhet të vendoset markimi CE referuar në pikën 8.1 dhe të shoqërohen nga deklarata EC të konformitetit.

6.2 Përputhshmëria e serive të prodhuara të boilerëve vërtetohet nga:

a) shqyrtimi i efijencës së një tipi boileri në përputhje me modulën B, siç përshkruhet në pikën 9.1;

b) një deklaratë konformiteti e tipit të miratuar në përputhje me modulën C, D ose E të përshkruar në pikat 9.2; 9.3 dhe 9.4.

Për boilerët që djegin lëndë djegëse të gaztë, procedurat për vlerësimin e konformitetit të efijencës së tyre do të jenë ato që përdoren për të vlerësuar përputhjen me kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik përkatës mbi pajisjet që përdorin lëndë djegëse të gaztë.

6.3 Kur pajisjet e tregtuara vendosen në treg të ndara, ato duhet të kenë shenjë CE dhe të shoqërohen nga deklarata EC e konformitetit, e cila përcakton parametrat që mundësojnë që pas montimit të arrijnë nivelet e rendimentit të dobishëm të përcaktuara në pikën 5.1.

6.4 Vendosja e markimit CE të konformitetit me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe me ato të kushteve të tjera në lidhje me dhënien e së drejtës së përdorimit të markimit CE, si dhe mbishkrimet e specifikuara në pikën 8, do të vendosen mbi boilerët në mënyrë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme. Ndalohet vendosja mbi këto produkte e çdo shenjë tjetër që mund të çorientojë palët e treta si në kuptimin, ashtu dhe në formën e vendosjes së markimit CE. Çdo shenjë tjetër mund të vendoset te boilerët dhe pajisjet vetëm me kusht që të mos ulet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE.

6.5 Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ose organi i autorizuar/i regjistruar evropian (më poshtë organi evropian) vërteton se markimi CE është vendosur në mënyrë jo të rregullt, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të bëjë pajtueshmërinë e boilerit me kushtet e lidhura me vendosjen e markimit CE dhe të japë fund shkeljes sipas kushteve të vëna nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

6.6 Kur mospërputhja në lidhje me rregullsinë e vendosjes së markimit vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes merr të gjitha masat administrative dhe bën ndalimin e bërjes së disponueshme në treg të produktit në fjalë në bazë të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

7. Organet e autorizuar/organizëm evropian


7.1 Ministria publikon në website-n e saj listën e organeve të autorizuar/organizmave evropianë me numrat e tyre të identifikimit dhe detyrat për të cilat ato janë autorizuar. Ministria siguron që kjo listë të mbahet e përditësuar.

7.2 Ministria zbaton kriteret minimale të përcaktuara në pikën 10 për autorizimin e organizmave të tillë. Organizmat, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në Standardet përkatëse të Harmonizuara Shqiptare gjykohet se plotësojnë kriteret e parashtruara në këtë pikë.

7.3 Ministri i cili ka autorizuar një organizëm të veçantë duhet t’ia heqë atij këtë të drejtë, nëse ai gjen se organizmi i autorizuar nuk plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin 7.2.

8. Vendosja e markimit CE

8.1 Vendosja e markimit CE të konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” si paraqitet në formën e mëposhtme:



8.2 Nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, respektohen përmasat e vizatimit të mësipërm të shkallëzuar.

8.3 Komponentët e markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk duhet të jetë më pak se 5 mm.

9. Modulet e vlerësimit të konformitetit

9.1 Shqyrtimi EC i tipit (moduli B)

9.1.1 Shqyrtimi i tipit EC është procedura nëpërmjet së cilës organi i autorizuar/organizmi evropian vërteton dhe deklaron se mostra përfaqësuese e prodhimit të parashikuar plotëson kushtet përkatëse të rregullit teknik.

9.1.2 Aplikimi për shqyrtimin e tipit EC paraqitet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar te një organ i autorizuar/organizëm evropian i zgjedhur nga vetë ai:

Aplikimi duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e fabrikuesit dhe, nëse aplikimi bëhet nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, duke shtuar emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që i njëjti aplikim nuk është paraqitur në një organ tjetër të autorizuar/organizëm europian;

c) dokumentet teknike, siç përshkruhen në pikën 9.1.3.

Aplikanti vë në dispozicion të organit të autorizuar /organizmit europian një mostër përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, me poshtë e quajtur “tipi”. Organi i autorizuar/organizmi europian kërkon mostra të tjera, nëse është e nevojshme për të kryer programin e provës.

9.1.3 Dokumentet teknike duhet të mundësojnë përputhjen e pajisjes me kërkesat e vlerësuara nga ky rregull teknik.

Ato, për një vlerësim të tillë, mbulojnë projektimin, prodhimin dhe funksionimin e pajisjes dhe përmbajnë:

a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;

b) projektin konceptual, vizatime prodhimi dhe skema të komponentëve, nënnyjeve, qarqeve etj;

c) përshkrimet dhe sqarimet e nevojshme për kuptimin e vizatimeve dhe skemave, si dhe për funksionimin e produktit;

d) një listë të standardeve të harmonizuara, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, të përcaktuara në pikën 5.2, dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat thelbësore të rregullit teknik kur standardet e harmonizuara të përcaktuara në pikën 5 nuk janë zbatuar;

e) rezultatet e përlogaritjeve të bëra gjatë projektimit, shqyrtimit e bëra etj;

f) raportet e provave të kryera.

9.1.4 Organi i autorizuar/organizmi europian:

a) shqyrton dokumentet teknike, verifikon nëse tipi është prodhuar në përputhje me këto dokumente dhe identifikon elementet, të cilat janë projektuar në përputhje me kushtet përkatëse të Standardeve të Harmonizuara të përcaktuara në pikën 5.2, si dhe elementet të cilat janë projektuar pa zbatuar kushtet përkatëse të këtyre standardeve;

b) kryen vetë ose nëpërmjet të tjerëve shqyrtimet përkatëse dhe provat e nevojshme për të verifikuar nëse zgjidhjet e përshtatura nga fabrikuesi plotësojnë kërkesat thelbësore të rregullit teknik, atje ku nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara të përcaktuara në pikën 5.2;

c) kryen vetë ose nëpërmjet të tjerëve shqyrtimet përkatëse dhe provat e nevojshme për të verifikuar nëse fabrikuesi që ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse, aktualisht i ka zbatuar ato;

d) bie dakord me aplikantin për vendet ku do të kryhen shqyrtimet dhe provat e nevojshme.

9.1.5 Kur tipi plotëson kushtet përkatëse të këtij rregulli teknik, organi i autorizuar/organizmi europian i lëshon aplikantit një certifikatë të shqyrtimit EC të tipit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e fabrikuesit, konkluzionin e shqyrtimit dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të aprovuar.

Një listë të pjesëve përkatëse të dokumenteve teknike i aneksohet certifikatës dhe një kopje mbahet nga organi i autorizuar/organizmi europian.

Nëse fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar i refuzohet certifikata e tipit, organi i autorizuar/organizmi europian jep arsyet e detajuara për këtë refuzim.

Në këtë rast parashikohet procedurë apelimi.

9.1.6 Aplikanti informon organin e autorizuar/ organizmin europian, i cili mban dokumentet teknike në lidhje me certifikatën e shqyrtimit EC të tipit për të gjitha modifikimet në pajisjen e aprovuar, për të cilat duhet të marrë aprovim tjetër, kur ndryshime të tilla mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore ose me kushtet e përshkruara për përdorimin e produktit. Aprovimi tjetër jepet në formën e një shtese te certifikata origjinale e shqyrtimit EC të tipit.

9.1.7 Organi i autorizuar/organizmi europian u komunikon organizmave të tjerë informacionin përkatës lidhur me certifikatat e shqyrtimit EC të tipit dhe shtesat e miratuara ose heqjen e tyre.

9.1.8 Organet e tjera të autorizuar/organizmat europianë mund të marrin kopje të certifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe/ose shtesat e tyre. Anekset e certifikatave EC të shqyrtimit të tipit mbahen në dispozicion të organeve të tjera të autorizuar / organizmave të tjerë europianë.

9.1.9 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban së bashku me dokumentet teknike edhe kopjet e certifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe shtesat e tyre për një periudhë së paku 10 vjet që nga prodhimi i fundit i produktit përkatës.

Kur as fabrikuesi as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk janë në Shqipëri, detyrimi për mbajtjen në dispozicion të dokumenteve teknike është nën përgjegjësinë e personit që e vendos produktin në treg.

9.2 Konformiteti i tipit (moduli C)

9.2.1 Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron dhe deklaron se pajisjet në fjalë janë në përputhje me tipin, e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik, që zbatohen mbi to. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do të vendosë shenjën CE në çdo pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

9.2.2 Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se procesi i prodhimit garanton përputhjen e pajisjeve të prodhuara me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit, si dhe me kërkesat e efikasitetit të këtij rregulli teknik.

9.2.3 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit të paktën për një periudhë 10-vjeçare nga data e fundit e prodhimit të produktit në fjalë.

Kur as fabrikuesi as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ndodhen në Shqipëri, detyrimin për disponibilitetin e dokumenteve teknike e ka personi që vendos produktin në treg.

9.2.4 Organi i autorizuar/organizmi evropian i zgjedhur nga fabrikuesi kryen ose detyron shqyrtimet e produktit në intervale rastësore. Një mostër e përshtatshme e produktit që merret në vendin e prodhimit nga organi i autorizuar/organizmi evropian shqyrtohet dhe testohet, sipas standardit/eve përkatës të përcaktuar në pikën 5.2 ose kryhen prova të njëvlershme për të kontrolluar përputhjen e produktit me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

Në rastin kur një ose më shumë mostra të produkteve të shqyrtuara nuk janë në përputhje, organi i autorizuar/organizmi evropian duhet të marrë masat përkatëse.

9.3 Sigurimi i cilësisë së prodhimit (moduli D)

9.3.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi, i cili plotëson detyrimet e pikës 9.3.2 siguron dhe deklaron se pajisjet janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotëson kërkesat e rregullit teknik që zbatohen mbi to.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos shenjën CE në çdo pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit i organit të autorizuar/organizmit evropian përgjegjës për kontrollet e përcaktuara në pikën 9.3.4.

9.3.2 Fabrikuesi operon me një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin përfundimtar të pajisjes dhe provave, të përcaktuara në pikën 9.3.3 dhe është objekt i kontrolleve të përcaktuara në pikën 9.3.4.

9.3.3 Sistemi i cilësisë

9.3.3.1 Fabrikuesi paraqet aplikimin për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për pajisjet tek organi i autorizuar /organizmi evropian i zgjedhur nga vetë ai.

Aplikimi përfshin:

- a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e parashikuar të pajisjes;
- b) dokumentet lidhur me sistemin e cilësisë;
- c) dokumentet teknike mbi tipin e aprovuar dhe një kopje të certifikatës, të shqyrtimit EC të tipit.

9.3.3.2 Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e pajisjeve me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e rregullit teknik që zbatohen mbi to.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga fabrikuesi dokumentohen me shkrim në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve. Dokumentet e sistemit të cilësisë lejojnë një interpretim të qëndrueshëm të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe regjistrave/dosjeve teknike të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

- a) objektivave të cilësisë, strukturës organizative, përgjegjësive dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e pajisjes;
- b) fabrikimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që janë përdorur;
- c) shqyrtimeve dhe provave që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, dhe frekuencën me të cilën ato kryhen;
- d) regjistrave të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, si dhe raporte mbi kualifikimin e personelit të përfshirë në to etj;
- e) mënyrave të monitorimit të realizimit të cilësisë së kërkuar të pajisjes dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

9.3.3.3 Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 9.3.3.2. Ai prezumon përputhjen me ato kërkesa që lidhen me sistemet e cilësisë që zbaton standardi përkatës i harmonizuar. Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet e punës së fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.3.3.4 Fabrikuesi merr përsipër plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe e ruan atë në një nivel të përshtatshëm dhe efektiv.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar, për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë organin e autorizuar/organizmin europian që ka aprovuar sistemin e cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi europian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë plotëson kërkesat e përcaktuara në 9.3.3.2 apo kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton fabrikuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.3.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit europian

9.3.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se fabrikuesi përmbush siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

9.3.4.2 Fabrikuesi duhet të lejojë që organi i autorizuar/organizmi europian të hyjë për qëllime inspektimi në ambientet e prodhimit, inspektimit, provave dhe magazinimit dhe t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

a) dokumentet e sistemit të cilësisë;

b) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj;

9.3.4.3 Organi i autorizuar/organizmi europian periodikisht kryen auditime që sigurojnë se fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe e pajis fabrikuesin me një raport auditimi.

9.3.4.4 Organi i autorizuar/organizmi europian mund të bëjë vizita të palajmëruara te fabrikuesi.

Gjatë vizitave të tilla, organi i autorizuar/organizmi europian kryen prova ose detyron të kryhen prova për të verifikuar që sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht; nëse duhet organi i autorizuar/organizmi europian pajis fabrikuesin me një raport mbi vizitën dhe, nëse ka kryer prova dhe raportin e provave.

9.3.4.5 Fabrikuesi, për një periudhë të paktën 10 vjet nga prodhimi i fundit i produktit, mban në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut :

a) dokumentin e përcaktuar në pikën 9.3.3.1. "b";

b) të dhënat e përcaktuara në pikën 9.3.3.4, paragrafi "b";

c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar /organizmit europian që janë të përcaktuara në pikën 9.3.3.4, paragrafi i fundit, në pikat 9.3.4.3 dhe 9.3.4.4.

9.3.4.6 Çdo organ i autorizuar/organizmi europian informon organizmat e tjerë mbi informacionin përkatës lidhur me lëshimin e aprovimeve të sistemit të cilësisë ose heqjen e tyre.

9.4 Sigurimi i cilësisë së produktit (moduli E)

9.4.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi, i cili plotëson detyrimet e pikës 9.4.2 siguron dhe deklaron se boilerët dhe pajisjet janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos shenjën CE në çdo boiler dhe pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit i organit të autorizuar/organizmit europian përgjegjës për kontrollet siç përcaktohet në pikën 9.4.4.

9.4.2 Fabrikuesi operon me një sistem të aprovuar cilësie për inspektimin përfundimtar dhe testimin e boilerit dhe pajisjes siç specifikohet në pikën 9.4.3 dhe është objekt i kontroleve siç përcaktohet në pikën 9.4.4.

9.4.3 Sistemi i cilësisë

9.4.3.1 Fabrikuesi paraqet te një organ i autorizuar/organizmi europian të zgjedhur nga vetë ai, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për boilerët dhe pajisjet e tij.

Aplikimi përfshin:

a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e kërkuar të boilerit ose pajisjes;

b) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

c) dokumentet teknike lidhur me tipin e aprovuar dhe një kopje të certifikatës së shqyrtimit CE të tipit.

9.4.3.2 Mbështetur në sistemin e cilësisë, çdo boiler ose pajisje i nënshtrohet shqyrtimit dhe kryerjes së provave përkatëse siç përcaktohet në standardin/et përkatës, përcaktuar në pikën 5.2 ose kryerjes së testeve të barasvlefshme që të sigurohet përputhja e tij me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga fabrikuesi dokumentohen me shkrim në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë lejon një interpretim në mënyrë të rregullt të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe dosjeve teknike.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

a) objektivave të cilësisë, strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e pajisjes;

b) shqyrtimeve dhe provave të kryera pas prodhimit;

c) mënyrave të monitorimit për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë;

d) regjistrave të cilësisë/dosjeve teknike të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi, të dhëna mbi testimet, të dhëna mbi kalibrimet, raporte të kualifikimit të personelit të përfshirë në to etj.

9.4.3.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 9.4.3.2. Ai prezumon përputhjen me ato kërkesa që lidhen me sistemet e cilësisë që zbaton standardi përkatës i harmonizuar.

Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet e punës së fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.4.3.4 Fabrikuesi merr përsipër plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe e mirëmban atë në një nivel të përshtatshëm dhe efektiv.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar, për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë organin e autorizuar/organizmin evropian që ka aprovuar sistemin e cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë plotëson kërkesat e përcaktuara në 9.4.3.2 apo kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton fabrikuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.4.4 Mbikëqyrja/monitorimi nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit evropian.

9.4.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se fabrikuesi përmbush siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

9.4.4.2 Fabrikuesi duhet të lejojë që organi i autorizuar/organizmi evropian të hyjë për qëllime inspektimi në ambientet e prodhimit, inspektimit, provave dhe magazinimit dhe t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) dokumentet teknike;

c) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.

9.4.4.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian periodikisht kryen auditime që sigurojnë se fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe e pajis fabrikuesin me një raport auditimi.

9.4.4.4 Organi i autorizuar/organizmi evropian bën vizita të palajmëruara te fabrikuesi.

Gjatë vizitave të tilla, organi i autorizuar/organizmi evropian kryen prova ose detyron të kryhen prova për të verifikuar që sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht; nëse duhet, organi i autorizuar/organizmi evropian e pajis fabrikuesin me një raport mbi vizitën dhe, nëse ka kryer prova, edhe me raportin e provave.

9.4.4.5 Fabrikuesi, për një periudhë të paktën 10 vjet nga prodhimi i fundit i boilerit ose i pajisjes, mban në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut:

a) dokumentet e referuara në pikën 9.4.3.1 “c”;

b) ndryshimet e referuara në pikën 9.4.3.4, paragrafi 2;

c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar/organizmit europian, të cilat janë përcaktuar në pikën 9.4.3.4, paragrafi i fundit në pikën 9.4.4.3 dhe 9.4.4.4.

9.4.4.6 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian informon organizmat e tjerë mbi informacionin përkatës lidhur me lëshimin e aprovimeve të sistemit të cilësisë ose heqjen e tyre.

10. Kriteret minimale që merren parasysh për autorizimin e organeve të autorizuara

10.1 Organi, drejtuesi i tij dhe stafi përgjegjës për kryerjen e provave të verifikimit nuk duhet të jenë projektues, fabrikues, furnizues ose instalues të pajisjeve të cilat ata inspektojnë, as përfaqësues të autorizuar të njërit prej këtyre personave. Ata nuk përfshihen as drejtpërdrejt ose si përfaqësues të autorizuar në projektim, konstruktim, marketing ose mirëmbajtje të boilereve dhe pajisjeve të tilla. Kjo nuk pengon mundësinë e shkëmbimit të informacionit teknik ndërmjet fabrikuesit dhe organit.

10.2 Organi dhe stafi i tij kryejnë provat e verifikimit dhe mbikëqyrjes në shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës teknike dhe janë të lirë nga të gjitha presionet dhe nxitjet, veçanërisht financiare, që influencojnë në gjykimet e tyre mbi rezultatet e inspektimit, veçanërisht nga persona ose grupe personash me interes në rezultatin e verifikimeve.

10.3 Organi duhet të ketë në dispozicion stafin e nevojshëm dhe të zotërojë mjetet e nevojshme që të kryejë në mënyrën e duhur detyrat administrative dhe teknike që lidhen me verifikimin; si dhe të ketë mundësinë për disponimin e pajisjeve të nevojshme për verifikime të veçanta.

10.4 Stafi përgjegjës për inspektim duhet të ketë:

a) formimin dhe trajnimin teknik profesional;

b) njohuri të mjaftueshme të kërkesave mbi provat që ata kryejnë dhe eksperiencë të mjaftueshme mbi këto prova;

c) aftësi në hartimin e certifikatave, regjistrimeve dhe raporteve që kërkohen për verifikimin e provave.

10.5 Paanësia e stafit duhet të jetë e garantuar. Shpërblimi i tyre nuk varet nga numri i provave të kryera ose nga rezultati i këtyre provave.

10.6 Organi i autorizuar pajiset me sigurimin e përgjegjësisë në përputhje me nenin 14, paragrafi 2/d të ligjit nr. 9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

10.7 Stafi i organit të autorizuar ruan sekretin profesional lidhur me të gjithë informacionin e grumbulluar gjatë kryerjes së detyrave të tyre (përfshijë autoritetet kompetente kombëtare) të përcaktuara në këtë rregull teknik ose në akte të tjera ligjore ose nënligjore.

VENDIM

Nr.1098, datë 4.11.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 8 nëntor 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake slovene, të përbërë nga 2 dy automjete dhe 7 (shtatë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datë 9 nëntor 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake slovene, të përbërë nga 4 (katër automjete) dhe 7 (shtatë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për autokolonën e përmendur në pikën 1 të vendimit, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për autokolonën e përmendur në pikën 2 të vendimit, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1163, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN
E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFAVE TË
SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

a) “Studime letrare”, me profilet:

i) “Teori letërsie dhe kritikë letrare”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Teori letërsie dhe kritikë letrare”;

ii) “Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar”;

iii) “Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore”.

b) “Gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Gjeografi”.

2. Programet e studimit, të ciklit të dytë, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi, të ciklit të dytë, ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimi në këto programe studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 100;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 100.

5. Kuota e pranimi, për studentë, që i ndjekin këto programe si programe të dyta studimi, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 5;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 5.

6. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 48 000 lekë;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 48 000 lekë.

7. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që i ndjekin këto programe studimi si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë:

- a) Në programin e studimit “Studime letrare” 130 000 lekë;
- b) Në programin e studimit “Gjeografi” 130 000 lekë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.30, datë 26.11.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 16.7.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti, që i përket:

Kërkues: Fatjon Sterkaj, përfaqësuar nga avokat Qazim Gjonaj, me prokurë.

Subjekt i interesuar: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

Objekti: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.91, datë 24.3.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.486, datë 27.7.1999, ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të kërkuesit Fatjon Sterkaj, për kryerjen e veprës penale “vjedhje me armë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal (KP).

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.322, datë 16.11.1999, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.486, datë 27.7.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kërkuesin, duke e deklaruar fajtor për veprën penale të “vjedhjes me armë”, në bashkëpunim, dhe e ka dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.91, datë 24.3.2000, ka vendosur, ndër të tjera, ndryshimin e vendimit nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkuesin, përse i përket cilësimit juridik të veprës, nga “vjedhje me armë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga

nenet 140 dhe 25 të KP-së, në “vjedhje me dhunë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me 7 vjet burgim.

Gjykimi i çështjes, në të tri shkallët, është bërë në mungesë të kërkuesit. Ky i fundit është shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Shkodër në datën 09.12.1998.

Kërkuesi është ekstraduar nga SHBA-ja në 4.6.2008. Në këtë datë nga oficeri i policisë gjyqësore të qarkut Shkodër është mbajtur procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit nr.486, datë 27.7.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.91, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Lartë, në ngarkim të kërkuesit.

Kërkuesi Fatjon Sterkaj, përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.91, datë 24.3.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me pretendimin se këto vendime janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, duke parashtruar këto argumente:

- Kërkuesi nuk është vënë në dijeni për procedimin penal deri në datën 4.6.2008, datë në të cilën i është komunikuar vendimi i Gjykatës së Lartë.

- Kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe e drejta që të dëgjohet para se të gjykohet, pasi nuk i janë komunikuar as ankimi i bërë nga prokurori kundër vendimit të gjykatës së rrethit, e cila e kishte deklaruar atë të pafajshëm për veprën penale të “vjedhjes me armë” në bashkëpunim, dhe as rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga bashkë i dënuari A.B.; ai nuk është vënë në dijeni as për datat e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë, të cilat e kanë gjykuar dhe dënuar në mungesë.

- Gjykata e Apelit Tiranë si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përmes deklarimit fajtor të kërkuesit, janë treguar tërësisht të njëanshme, duke paragykuar fajësinë e të gjykuarit në procesin ligjor dhe duke shkelur të drejtat e tij themelore.

II

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe e drejta që të dëgjohet para se të gjykohet, pasi nuk i janë komunikuar as ankimi i bërë nga prokurori kundër vendimit të gjykatës së rrethit, e cila e kishte deklaruar atë të pafajshëm për veprën penale të “vjedhjes me armë” në bashkëpunim, dhe as rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga bashkë i dënuari A.B. Ai pretendon gjithashtu se nuk është vënë në dijeni as për datat e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, dhe në Gjykatën e Lartë, të cilat e kanë gjykuar dhe dënuar në mungesë.

Gjykata, në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh të saj, ka pranuar si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal, garantimin e mbrojtjes. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale, efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t’i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.11.2003; nr.5, datë 17.2.2003*).

E drejta e çdo të akuzuari penalisht, për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë. Gjykata rithekson se mospjesëmarrja në gjykim të të akuzuarit, në çdo rast, edhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përlligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t’i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 17.2.2003*).

Për vetë natyrën e tyre, barazia e armëve dhe shanseve dhe për rrjedhojë, vetë parimi i kontradiktoritetit, luajnë rol tepër të rëndësishëm sidomos në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, normalisht është vetë shteti. Në këto kushte, kërkesat e mësipërme janë praktikisht në shërbim të mbrojtjes së personit të akuzuar, i cili gjatë gjithë procesit, deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga gjykata, prezumohet si i pafajshëm. Pikërisht për këtë arsye, shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për t’i siguruar atij ose përfaqësuesit të tij pjesëmarrjen në proces dhe përmes saj, edhe mundësinë e njohjes dhe deklarimit për të gjitha faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që i referohen akuzës së bërë.

Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe në dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 2.4.2009; nr.19, datë 18.9.2008; nr.13, datë 21.7.2008; nr.16, datë 8.6.2006*).

Në dallim nga procesi civil, procesi penal i shkallës së parë e të dytë, në referim të Kodit të Procedurës Penale, është konceptuar për çdo rast si proces që zhvillohet me mbrojtës, të cilin, në raste të caktuara nga ligji, nuk përjashtohet ta caktojë edhe vetë gjykata. Kjo për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme që ka në një shtet demokratik garantimi i lirisë së personit nga çdo cenim. Megjithatë organet e gjykimit nuk mund të bëhen përgjegjës për çdo mosparaqitje në seancë nga ana e të gjykuarit ose avokatit të tij, u takon këtyre organeve të ndërmarrin hapa për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura nga Kushtetuta, siç është e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve si element i saj përbërës. Garantimi i kësaj të drejte merr rëndësi dhe për arsye se, me paraqitjen e rekursit nga prokurori, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Në këto rrethana, pjesëmarrja e të gjykuarit dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij, kërkohet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces gjyqësor, (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 19.2.2007*).

Garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të respektohen edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Mënyra me të cilën aplikohen këto garanci në gjykimin në këtë Gjykatë, duhet të varet nga karakteristikat e veçanta të procesit në këtë instancë, në mbajtjen parasysh të tërësisë së procesit (pra, në të tri shkallët) dhe në rolin e Gjykatës së Lartë në këtë proces (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 12.6.2003*). Gjikata është shprehur se përgjithësisht seancat gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit dhe se pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh se debati zhvillohet për çështje të ligjit, nuk është automatikisht e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Në rast se as avokati, dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohej nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.13, datë 21.7.2008*).

Në çështjen në shqyrtim, siç rezulton nga dokumentet e dosjes gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.486, datë 27.7.1999, e ka deklaruar kërkuesin të pafajshëm për kryerjen e veprës penale “vjedhje me armë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal (KP). Në këtë gjykim kërkuesi është mbrojtur nga avokati i caktuar kryesisht. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim organi i prokurorisë, i cili, ndër të tjera, ka kërkuar deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të përmendur më sipër. Komunikimi i ankimit të prokurorit është bërë me shpallje, pasi ka rezultuar se kërkuesi, Fatjon Sterkaj, nuk ka marrë dijeni, pas disa përpjekjesh për t’i bërë këtë komunikim, për shkak se adresat kanë qenë të pasakta (akti nr.259, datë 12.9.1999). Gjykata e Apelit Tiranë e ka gjykuar çështjen në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij dhe, në përfundim, me vendimin nr.322, datë 16.11.1999, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “vjedhjes me armë”, në bashkëpunim, dhe e ka dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim.

Gjykata çmon se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka përmbushur detyrimet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes të të akuzuarit në procesin penal. Vetëm nëpërmjet garantimit të të drejtës së mbrojtjes realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë me objektivitet e paanësi. Siç u theksua dhe më sipër, mospjesëmarrja në gjykim të të akuzuarit në çdo rast, edhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Interesat e drejtësisë e kërkonin detyrimisht realizimin e mbrojtjes së kërkuesit, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, duke pasur parasysh që gjykimi nga Gjykata e Apelit është bërë mbi bazën e ankimit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, është kërkuar një rëndim i

dukshëm i pozitës së kërkuesit në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata mban të njëjtin qëndrim edhe përsa i përket gjykimit të kërkuesit në Gjykatën e Lartë. Siç rezulton nga dosja gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.91, datë 24.3.2000, ka vendosur, ndër të tjera, ndryshimin e vendimit nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkuesin, përsa i përket cilësimit juridik të veprës, nga “vjedhje me armë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të KP, në “vjedhje me dhunë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me 7 vjet burgim. Gjykimi është bërë në mungesë të kërkuesit dhe të mbrojtësit të tij. Bazuar në standardet e përmendura me sipër, Gjykata e Lartë, në kushtet kur Gjykata e Apelit ka gjykuar kërkuesin, në mungesë të tij dhe të mbrojtësit dhe ka rënduar pozitën e tij në krahasim me gjykimin në shkallën e parë, ka pasur detyrimin për të siguruar mbrojtjen e kërkuesit në këtë gjykim, qoftë dhe nëpërmjet caktimit të një avokati kryesisht. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ishte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, si e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes këtij të fundit, të realizonte të drejtën për t’u mbrojtur.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në gjykimet e zhvilluara nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është cenuar e drejta e kërkuesit për t’u mbrojtur në procesin penal, që është një nga elementët e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

2. Lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të paanshmërisë në gjykimin në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përmes deklarimit fajtor të kërkuesit, janë treguar tërësisht të njëanshme, duke paragjykuar fajësinë e të gjykuarit në procesin ligjor dhe duke shkelur të drejtat e tij themelore për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me parimin e paanshmërisë si aspekt i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në fjalë në një çështje të dhënë; dhe i dyti, në vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe, mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 3.5.2007; nr.15, datë 22.7.2008*).

Kërkuesi, bazuar në elementet e përmendura më sipër, nuk ka parashtruar argumente për të mbështetur pretendimin e tij për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të pambështetur këtë pretendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimeve nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.91, datë 24.03.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për sa i përket të gjykuarit Fatjon Sterkaj.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar)

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. Shumica ka anashkaluar në vendimin e saj një element të qenësishëm, që ka të bëjë me legjitimitimin e kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Është e vërtetë se kërkuari Fatjon Sterkaj është ekstraduar nga SHBA-ja, me datë 4.6.2008 dhe se pikërisht në këtë datë i është komunikuar nga policia gjyqësore e qarkut Shkodër një procesverbal mbi ekzekutimin e vendimit penal nr.486, datë 27.7.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.91, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Lartë.

2. Kërkuari, duke pretenduar se nuk ka pasur dijeni për procedimin penal ndaj tij, në mbështetje të nenit 147 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë ankim ndaj vendimeve të sipërpërmendura. Kjo gjykatë e ka shqyrtuar kërkesën dhe me datë 16.2.2009, ka vendosur mospranimin e saj me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit.

3. Sipas nenit 30 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", "kur në bazë të ligjit individ mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave". Në përputhje me këtë rregullim juridik, si dhe në mbështetje të nenit 147 pika 6 të Kodit të Procedurës Penale, kërkuari Fatjon Sterkaj, kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që vendoste mospranimin e kërkesës së tij për t'u rivendosur në afat, mund dhe duhej të bënte ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjë që, siç rezulton nga materialet e çështjes, nuk e ka bërë.

4. Me datë 27.3.2009 kërkuari, pa shterur të gjitha mjetet e ankimit, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.322, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.91, datë 24.3.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se ato janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Kërkuari, pavarësisht se ka humbur të drejtën për tu rivendosur në afat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e çmon të justifikuar pretendimin e tij se ka marrë dijeni për procedimin penal në datën që është ekstraduar në Shqipëri, pra më 4.6.2008. Në këtë mënyrë, sipas tij afati 2-vjeçar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, i parashikuar në nenin 30 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" duhet të fillojë nga data 4.6.2008 dhe jo nga data 24.3.2000 kur është marrë vendimi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

5. Shumica, duke legjitimuar kërkuarin Fatjon Sterkaj, jo vetëm ka vepruar në kundërshtim me nenin 30 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, sepse ka pranuar një kërkesë nga një individ që nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar në rrugën e juridiksionit të zakonshëm, por, nga ana tjetër, nuk ka dhënë asnjë argument në vendimin e saj se përse kërkuari është në afat për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese pas rreth 9 vjetëve nga dënimi i tij?!

Për këto arsye, shumica duhet të vendoste rrëzimin e kërkesës së Fatjon Sterkajt për mungesë legjitimitimi për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Anëtar: Vladimir Kristo (kryetar)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 9.12.2009
Doli nga shtypi më 9.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë